


Dësë

Viti 4 • Numri 14 • Prill - Qershor 2016



Singeriteti
është zemra e veprës

TË
RINJ

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*

Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro



Ka njerëz të cilëve u shkëlqejnë fytyrat nga drita që kanë në shpirt;
të gjithë ne mezi presim që t'i shikojmë... Sytë e tyre nuk përmbajnë
asnjë hije dyshimi apo shqetësimi...

Ekzistojnë fjalë të tilla të ëmbla, që të mbushin me një qetësi të
fuqishme dhe të përkëdhelin shpirtin...

Ka sy të tillë që të shtojnë jetë...

Ka buzëqeshje që në momentin që shfaqen në fytyrë të bëjnë të
harrosh çdo shqetësim dhe problem; në këto buzëqeshje fshihet një
gur i çmuar, emri i tij është sinqeritet... I zbritur nga qielli në tokë, i
pastër si drita e parë e mëngjesit, qetësi e mbushur me dritë.

Sinqeriteti është si një bahçe me shumë fruta. Njerëzit që e kanë
këtë bahçe janë të pasur nga çdo aspekt, janë të pasur në dashuri,
besim dhe bujari... Ata nuk i përulen askujt veç Allahut... Ata shijojnë
bukurinë e besimit...

Në mahsher sillet një fletore e mbushur me sexhde dhe bamirësi.
I zoti i këtyre i shikon me vëmendje punët e vendosura në peshore.
Shikon se veprat e tij u zhveshëm dhe pyet me frikë:

"Ku janë adhurimet që kam bërë ditë e natë?"

Menjëherë vjen një përgjigje:

"Punët e bëra pa sinqeritet nuk kanë vend në peshore!... Nëse ka
hipokrizi, çdo gjë humbet!..."

Sinqeriteti është një dhuratë që Allahu u jep njerëzve që kanë
kujdes për të mos devijuar nga rruga e drejtë... Allahu ua jep këtë
bekim njerëzve që lenë gjumin e ëmbël të natës për t'u përkulur para
Krijuesit dhe për t'iu lutur Atij.

BOTUESI
Shtëpia Botuese "Progresi"

DREJTOR
Albert Halili

KRYEREDAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj
PËRKTHYES
Ernida Kraja | Eva Kajti
Naile Sulaj
DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
L: Vasil Shanto; Rr: Çajupi
Shkodër; Shqipëri
MOBILE
+355 67 607 8484
E-MAIL
revetika@gmail.com

VITI: IV
NUMRI: 14
Prill-Qershor
2016

Përmbajtja



**Gratë që janë kurorëzuar
me martirizim**
Tuba Çenari **12**

Ç'ndodhi me ju...
Zahide Topçu **5**

**Njeriu do të vdesë
vetëm një herë**
Fatma Hale Liman **6**

Pozita e dëshmorit
Kybra Çoban **10**



Haku i robit
Osman Nuri Topbash **20**

**Kush janë
dëshmorët**
Seher Ajdën **16**

**Sinqeriteti,
paqja e zemrës**
Aishegyl Zobi **22**

**Sinqeriteti
në adhurim
dhe në shërbim**
Halime Demireshik **24**

**Termi
"robëreshë"
në Islam**
Rukije Gjengly **26**



**Përdorimi
i parfumit**
Kevser Atar **30**

**Oqeani i mëshirës,
Pejgamberi ynë**
Shefika Kaja Meriç **28**

**Klithma e fqinjët
të uritur**
Shefika Kaja Meriç **32**

Vlera e shërbimit
Elif Menxhet **33**

**Komunikimi në
familje**
Adem Gynesh **34**

**Mos më lër
vetëm o Zot...**
Bejza Kurtullush **36**

Ç'ndodhi me ju...

Allahu Teala i ka krijuar njerëzit me cilësi të ndryshme. Dikush është i fortë, dikush i dobët e i pafuqishëm. Dikush ka lindur e është rritur në një familje të madhe, madje në fis; dikush është detyruar ta vazhdojë jetën edhe pa prindërit. Dikush është i pasur, dikush i varfër e nevojtar.

Urtësia më e madhe e krijimit të botës në këtë mënyrë me ndryshime e llojllojshmëri, është "sprovimi". A e shikon i pasuri të varfrin dhe a kujdeset për të? A e mbron i forti të dobëtin? A shqetësohen ata që kanë prindër për të pastrehët, vejushat dhe jetimët? Kështu në Ditën e Kiametit do të pyetet i pasuri nga i varfri; i varfri nga i pasuri...

Nëse njerëzit e fortë e të fuqishëm kanë filluar ta përdorin për keq fuqinë e tyre dhe i lëndojnë të tjerët, janë myslimanët ata që duhet ta ndalojnë këtë. Allahu Teala, ashtu siç ua ka lënë amanet myslimanëve fenë më të fundit dhe më të përsosur, u ka lënë amanet edhe të gjithë të dhunuarit, të vetmuarit, jetimët, të uriturit dhe nevojtarët.

Myslimanët e kanë obligim të çojnë te njerëzit zemrën e Islamit të mbushur me mëshirë e dhembshuri. Një besimtar nuk mund të flejë i ngopur ndërkohë që fqinji është i uritur. Ai nuk mund të qëndrojë indiferent ndërkohë që njerëzit në cepin tjetër të botës lëndohen. Në ajetin fisnik thuhet:

"Ç'keni ju që nuk luftoni në udhë të Allahut dhe për shpëtimin e të shtypurve: për meshkujt e pafuqishëm, gratë dhe fëmijët, të cilët thërrasin: "O Zot! ynë! Nxirrna nga ky qytet, banorët e të cilët janë keqbërës! Na cakto një mbrojtës dhe na dërgo nga ana Jote dikë që të na ndihmojë!" (Nisa, 75.)

Për t'u nisur drejt një synimi kaq sublim, bota

me gjërat e bukura që ka nuk mund të jenë, nuk duhet të jenë pengesë për besimtarin. Në ajetin 24 të sures et-Teube thuhet:

Thuaj: "Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur."

Padyshim xhihadi (përpjekja në rrugë të Allahut), është shumë e vështirë e i mundimshëm, por nuk janë vetëm besimtarët që lëndohen:

"Mos u tregoni të dobët në ndjekjen e jobesimtarëve! Nëse ndjeni dhimbje prej luftës, edhe ata ndiejnë dhimbje ashtu si edhe ju. Mirëpo ju shpresoni prej Allahut atë që ata nuk e shpresojnë. Allahu është i Gjithëdijsëm dhe i Urtë." (Nisa, 104)

Po, besimtarët shpresojnë që si shpërblim të këtyre vuajtjeve të fitojnë kënaqësinë e Allahut, xhenetin dhe në xhenet të nderohen me bukuritë e Allahut Teala.

Myslimanët, ashtu siç ndeshen me armiqtë e jashtëm dhe vështirësitë e xhihadt, ndeshen edhe me nefsin e tyre dhe vesveset e hipokritëve, sepse djalli dhe ndihmësit e tij marrin pjesë në xhihad dhe thonë për dëshmorët: "Nëse do të rrinin me ne dhe nuk do të shkonin në luftë, nuk do të vdisnin, nuk do të vriteshin." Ndërsa Allahu Teala u përgjigjet atyre:

"Atyre që nuk luftuan dhe thanë për vëllezërit e vet: "Sikur të na kishin dëgjuar ne, nuk do të ishin vvarë", thuaju: "Prapësojeni vdekjen nga vetja, nëse flisni të vërtetën! Kurrësi mos i quani të vdekur ata që janë vvarë në rrugën e Allahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre. Janë të gëzuar për çfarë u ka dhënë Allahu nga dhuntitë e Tij dhe gëzohen edhe për ata që ende nuk u janë bashkuar e që kanë ngelur pas tyre (dhe ende nuk kanë rënë martirë), sepse nuk do të frikësohen (për çfarë i pret) dhe nuk do të pikëllohen (për çfarë kanë lënë pas). Ata gëzohen me dhuntitë dhe mirësinë e Allahut, sepse Allahu nuk ua humb shpërblimin besimtarëve." (Al Imran, 168-171)

Lum për ata që fitojnë nderimin dhe mirësinë e veçantë të Allahut Teala!.. Lum për ata që bien dëshmorë dhe dalin në audiencën e Zotit (xh.xh.)!.. O Zot! Na bashko edhe ne me ata!.. Amin.



Njeriu do të vdesë vetëm një herë

Një natë më zgjoi nga gjumi një zhurmë e madhe. Ishte zëri i ambulancës që përzihej me zhurmën e lagjes. Ndërsa zëri më i tmerrshëm që vinte, ishte klithma e një gruaje:

“Nuk dua të vdes, ju lutem më shëroni!..”

Nuk munda të dal nga shtëpia në mes të natës, por klithmat “Nuk dua të vdes!” gjithë natën më buçitën në vesh. Të nesërmen e mësova se ç’kishte ndodhur; një grua rreth të shtatëdhjetave, që jetonte e vetme në pallatin përballë, ishte sëmurë; fqinjët kishin thirrur ambulancën për ta çuar në spital... Gruaja vetëm bërtiste:

“Nuk dua të vdes!.. Nuk dua të vdes!”

Gruaja vdiq... Pas një jave ndërroi jetë.

Për ditë të tëra ky zë jehoi në trurin tim: “Nuk dua të vdes!”

Siç ka lindje, ka edhe vdekje. Madje, kjo është një e vërtetë absolute... Do të na vijë pa lajmëruar, papritur... Do të na vijë papritur dhe ne nuk do ta duam këtë vdekje si zonja e do të bërtasim në çastet e fundit:

“Nuk dua të vdes!”?

Kaq e tmerrshme është vdekja? A janë normale këto klithma? A është normale që të duam me kaq ambicie të jetojmë edhe kur vjen koha të frikësohemi nga vdekja?

Kemi dëgjuar shumë transmetime në lidhje me vdekjen, sidomos për tmerrin e saj... Tregohet se personi të cilin populli i kishte kërkuar Isait (a.s.), ta ringjallte,



foli me të shpirtërisht dhe i tha:

“Nëse do ta përjetoj sërish dhimbjen e vdekjes, të lutem mos e ringjall trupin tim!..”

Në një hadith fisnik njoftohet se shpirtrat e jobesimtarëve do të *“dalin siç tërhiqet e del një shtizë me ganxha nga leshti i lagur”*, ndërsa shpirtrat e besimtarëve do të *“dalin siç rrjedh e bie pika e ujit nga një kapak”*. (Shik. Hakim, I, 93-95/107)

E dhimbshme por aq edhe e tmerrshme... Dhimbjet që ndjehen në çastin e vdekjes nuk janë të njëjta te të gjithë njerëzit, por ndryshojnë sipas veprave të tyre. Prandaj kush mund të jetë i sigurt se do ta dorëzojë shpirtin në paqe në frymën e fundit?...

Në “Mesnevinë” e Mevlanës thuhet:

“Vdekja e atij njeriu që ka kaluar një jetë të ëmbël në pasuri, është e dhimbshme, sepse e ka të vështirë të ndahet nga gjërat me të cilat është mësuar. Nuk mund ta shpëtojë shpirtin i cili adhuronte trupin dhe i plotësonte çdo dëshirë nefsit të tij.”

Vështirësia e çastit të vdekjes është në lidhje të drejtpërdrejtë me varësinë ndaj kësaj bote... Kush është i dhënë së tepërmi pas kësaj bote, kënaqet nga argëtimet dhe dëfrimet, “ehli kejf”, nuk e duron ndarjen e shpirtit nga trupi të cilin nuk mundi ta lëndonte në këtë botë dhe reziston për të mos vdekur... Ai bërtet:

“Nuk dua të vdes, nuk dua të vdes...”

Kjo gjendje, klithma e nefsit shpreh se si është konsumuar gjithë ajo jetë.

Strehohemi te Allahu për frymën e fundit ashtu siç strehohemi për çdo gjë...

Kështu luteshin gjithmonë të parët tanë; kështu thoshte edhe gjyshja ime, tani thotë edhe nëna:

“O Zot! Mos na lër të vuajmë në shtratin e vdekjes, mos na lër në dorën e askujt, mos na jep vdekje të keqe!.. Na mundëso që të qëndrojmë tre ditë në shtratin e vdekjes, të marrim uratën e njerëzve, të pimë ujë zemzemi, të na këndohet Jasini fisnik dhe ditën e katërt të japim frymën e fundit me një përfundim të mirë duke thënë shehadetin.”

Ai që nuk lutet për frymën e fundit, është një hiç, sepse kjo është e vërteta më e madhe e jetës... Ne nuk duam vdekje të vështirë, duam vdekje të lehtë.

Në fakt askush nga ne nuk e do vdekjen. Pyetja e parë që na vjen në mendje kur sëmuremi apo aksidentohemi rëndë, është:

“Vallë, do të vdes?”

Në çështjen e vdekjes kemi shumë probleme dhe konflikte të brendshme. Këto konflikte janë më shumë te ata që e kanë besimin të dobët. Ai që e ka besimin të përsosur nuk e ka problem vdekjen dhe e pranon takimin me Allahun ashtu si Mevlana që thotë: “Vdekja është diçka e bukur!..”

Edhe Pema e ndaluar për Ademin dhe Havanë ishte që të shpëtonin nga e përkohshmja, pra që të

mos vdisnin. Në përbërjen e njeriut ekziston mendimi i të qenit i përhershëm dhe mosdëshira për të qenë i përkohshëm... Nefsi bën çdo gjë për të mos vdekur!.. Sepse ligjet e tij kanë vlerë vetëm në këtë botë. Nefsi nuk ka vend në ahiret!.. Sepse sprova mbaron. Sprova bëhet aty ku ka nefsi, aty ku është djalli; në vendet ku që të dy janë më aktivë... Ahireti është vendi ku edhe djalli, edhe nefsi janë të pavlerë.

Prandaj njeriu nuk e do atë botë në të cilën nefsi merr fund e i humb vlera dhe kapet fort pas kësaj bote. Ata që nuk e edukojnë nefsin dhe që nuk e arrijnë kënaqësinë, kapen pas kësaj bote sikur nuk do të vdesin kurrë. Pra, me një dëshirë të madhe sikur nuk do të vdesin kurrë...

Në qoftë se te robi ekziston mendimi i të qenit i përhershëm, i pavdekshëm, atëherë duhet të jetë një derë e hapur, duhet të plotësohen në një mënyrë këto kërkesa të robërve, nuk duhet të vdesin me të vërtetë... Ndoshta duhet t’u ndërrohet vend, duhet të shpërngulen për në ahiret, por mendja e llastuar e njeriut mendon se “nuk duhet të bëhet kufomë”... Allahu ka fuqi për çdo gjë dhe këto kërkesa të robërve i pranon vetëm me një kusht:

“Jepe frymën tënde të fundit në rrugë të Allahut!..”

Ja atëherë mos ndiej dhimbje vdekjeje dhe quaje veten të gjallë. Pra jo një kufomë e radhës, por qëndro e gjallë dhe e freskët. Në ajetin 154 të sures Bakara thuhet:

“Dhe mos thoni për ata që vriten në rrugën e Allahut se janë të vdekur! Jo! Ata janë të gjallë, ndonëse ju nuk e ndjeni!”

Ndërsa në suren Al-i Imran, në ajetet 169-171 thuhet:

“Kurrsesi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e Allahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre. Janë të gëzuar për çfarë u ka dhënë Allahu nga dhuntitë e Tij dhe gëzohen edhe për ata që ende nuk u janë bashkuar e që kanë ngelur pas tyre (dhe ende nuk kanë rënë martirë), sepse nuk do të frikësohen (për çfarë i pret) dhe nuk do të pikëllohen (për çfarë kanë lënë pas). Ata gëzohen me dhuntitë dhe mirësinë e Allahut, sepse Allahu nuk ua humb shpërblimin besimtarëve.”

Kur Elmallëllë Hamdi Jazër bëri komentin e këtyre ajeteve në tefsirin me titull “Feja e vërtetë Gjuha e Kuranit”, tha:

“Jeta e dëshmorit është një jetë shpirtërore, më saktë një jetë e vërtetë.”

Ndërsa Said Nursiu e shpjegon këtë ajet fisnik duke thënë:

“Dëshmori e quan veten të gjallë. E gjen veten në një botë më të bukur pa i ndërë dhimbjet e vdekjes.”

Në Beshiktash ishte një gjyshe e nderuar nga fisi Sejjid. Një natë, kur po merrte abdest, ndjeu se u hap dera dhe dikush po e priste në korridor. Kur doli nga tualeti, pa përballë saj një djalosh me veshje ushtarake

i cili ia kishte ngulur sytë. Papritur burri u zhduk... Kur e tregoi këtë ngjarje gjatë bisedës që zhvilloim, vetëm një mësuese që i besonte shkencës, realiste dhe racionaliste i tha:

“Mos u frikësoni, nuk ka asgjë, keni parë halucinacione!..”

Ne bëmë kërkime për të mësuar të vërtetën e kësaj ngjarjeje. Ndodhia nuk ishte halucinacion dhe në të vërtetë shtëpia ku jetonte zonja, ishte ndërtuar mbi varrin e një dëshmorit. Zonja e kishte blerë shtëpinë pa e ditur këtë të vërtetë. Dëshmorit, mbi varrin e të cilit ishte ndërtuar shtëpia, shpeshherë vinte dhe i vizitonte njerëzit e shtëpisë. Por jo të gjithë e shikonin atë. Vetëm njerëz të veçantë mund ta shihnin. Këtë histori e kam dëgjuar edhe nga njerëz të tjerë. Dëshmorët nuk janë “kufoma”, por janë krejt të gjallë... Ata akoma kujtojnë se jetojnë. Nëse zonjën e zë gjumi pa falur namazin, ky dëshmor e lëviz derën dhe nuk e lë atë të flejë!.. Disa nga gratë e xhematit e besuan e disa të tjera jo. Allahu Teala thotë:

“Edhe pse ju mund të mos e kuptoni këtë gjendje, ata janë të gjallë!”

Ai që do të bjerë dëshmor, nuk do t'i ndjejë dhimbjet e vdekjes dhe do të qëndrojë me të vërtetë i gjallë. Kjo është një mrekulli dhe një mirësi e madhe... Edhe pse njeriu mund ta ketë vështirë ta kuptojë këtë gjendje, kjo është një dhuratë e mrekullueshme që Allahu (xh. xh.), ia ka dhënë njeriut... Nga kush mund të ketë frikë një njeri që me këtë besim nuk ka frikë nga vdekja dhe e vret vdekjen?.. Të gjithë le të frikësohen nga ai. Cili armik mund të qëndrojë përballë një ushtrie që nuk i trembet vdekjes?! Halid bin Velidi, (r.a.), i thotë komandantit të Iranit:

“Kam ardhur përballë jush me një ushtri që e do vdekjen aq sa ju doni jetën dhe verën!..”

Si të përballet tani komandanti i ushtrisë së Iranit me këtë iman që nuk i trembet vdekjes... A mund ta mposhtë mizori një njeri i cili dëshirën më të madhe në zemër e ka të bjerë dëshmor, qan gjithmonë duke thënë: “O Zot! Më mundëso të bie dëshmor!”, lutet dhe e mban këtë besim çdo çast të freskët dhe të gjallë në zemër?

“Meqë njeriu do të vdesë vetëm një herë, atëherë përse të mos vdesë për Allahun?”

Ai rob që çdo ditë e bën nji: “Edhe jeta ime, edhe vdekja ime është për Zotin e botëve që është Allahu!..”, që është i vendosur në këtë mendim, nuk bën gjë tjetër përveçse dëshiron të jetë dëshmor.

Një zonjë tregoi shqetësimin e saj me këto fjali:

“E kam të lehtë të kërkoj me gojë të bie dëshmor, por e kam shumë të vështirë kur më ndodh ndonjë gjë. Po nëse nuk vdes dhe bëhem barrë e njerëzve?! Po nëse na vrasin duke na bërë tortura të tmerrshme!.. A nuk i vrau armiku gratë e Bosnje Hercegovinës duke i përdhunuar e bërë tortura të papërballueshme?! Unë nga

këto lloj torturash kam frikë. Për këtë arsye kam pak frikë të bie dëshmor. Po nëse jap shpirt nga torturat dhe jo nga një plumb i vetëm?

Në Kuranin Famëlartë flitet për “popullin e he-ndekut”, myslimanët të cilët binin dëshmorë duke u groposur të gjallë!.. Kishte edhe nga ata të cilët i hidhnin në kazanë me vaj të nxehtë; të cilëve ua hiqnin mishin nga koca me krehër hekuri... Të cilët vriteshin me tortura Faraoni, duke iu prerë këmbët e duart dhe duke u varur mbi ta... Kurani i thotë të gjitha këto. Vallë unë duhet të lutem:

“O Zot! Të sëmurem, por të qëndroj vetëm tri ditë në shtrat dhe ditën e katërt ma merr shpirtin!”

Çdo gjë e bukur dhe çdo mirësi, kërkon një shpërblim si kundërvlerë. Gjërat me vlerë i marrim duke paguar çmime të larta. Ato kurrë nuk jepen lirë. Pozita e dëshmorit bëhet shkak për faljen e të gjitha mëkateve përveç hakut të robit siç thuhet në një transmetim, ia mundëson dëshmorit që të hyjë në xhenet pa llogari, është lehtësim për dëshmorin në momentet e fundit aq sa e bën të mos ndjejë dhimbjen e vdekjes e cila është më e fortë se dhimbjet e çdo lloj torture që mund të ndjejë dhe më e rëndësishmja, ai qëndron gjithmonë në jetë, i gjallë dhe nuk vdes brenda në dhe...

“Allahu ia fal të gjitha mëkatet dëshmorit përveç hakut të robit.” (Muslim, Imare, 32)

A jepen lirë të gjitha këto mirësi? A i jepet diçka njeriut pa paguar një çmim? Atëherë, ai që dëshiron të bie dëshmor, duhet ta kërkojë këtë duke i ditur të gjitha këto... Në fakt, të kërkojë të biesh dëshmor duke i pranuar të gjitha këto kushte, duhet një besim shumë i fortë. Sipas një transmetimi munafikët (hipokritët) nuk dëshirojnë kurrë të bien dëshmorë, ndërsa ata që e kanë besimin të fortë, e thonë vazhdimisht lutjen e dëshmorit, pothuajse e bëjnë lutje të përditshme.

A e fiton gradën e dëshmorit çdo njeri që bën xhihad në rrugë të Allahut? Ata bëhen luftëtarë por jo dëshmorë, sepse Allahu Teala e shpërndon gradën e të rënit dëshmor ashtu siç shpërndon riskun dhe udhëzimin. Pra, kjo është punë kështimi. Ja Halid bin Velidi që ishte një komandant i madh!.. Ndërkohë që nuk kishte vend të trupit pa plagë, frymën e fundit e dha në shtratin e vdekjes dhe tha:

“Luftova dhe vrapova nëpër shumë fronte. Shikoni gjendjen time; po jap shpirt në shtrat si gratë!..”

Në njërën nga luftërat në të cilën mori pjesë Halid bin Velidi, bisedoi rreth Islamit me komandantin Bizantin dhe ai, një orë pasi ishte bërë mysliman, ra dëshmor në radhët e ushtarëve myslimanë. Të biesh dëshmor me një orë mysliman... Ky është një stimul i madh për kalimin në Islam të jobesimtarëve... Me të vërtetë është punë kështimi të biesh dëshmor në fushën e betejës... Një kështim që nuk i jepet gjithkujt... Njeriu mendon: “A shkuan kot të gjitha mundimet e Halid bin Velidit, (r.a.)? Sigurisht që nuk kanë shkuan kot? Edhe të luftuarit në rrugë të Allahut Teala është një mirësi e

madhe..." I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë:

"Ai që dëshiron me gjithë zemër të bjerë dëshmor, edhe nëse vdes në shtrat, Allahu ia mundëson gradën e dëshmorit." (Muslim, Imare, 157.)

Fjala "dëshmor" si cilësi e njeriut, ka kuptime të ndryshme. Ata që dëshmojnë diçka, quhen shehidë (dëshmitarë). Edhe ata që shikojnë e dëgjojnë të vërtetat, dhe që nuk janë neglizhentë, quhen shehidë (dëshmitarë). Besimtarët që vriten në rrugë të Allahut quhen "shehidë" (dëshmorë) në mënyrë që të dëshmohet në këtë botë se i vdekuri është prej banorëve të xhenetit dhe për shkak se në të vërtetë nuk vdes por është i gjallë.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë:

"Dëshmorët do dëshirojnë të kthehen përsëri në këtë botë dhe të vriten dhjetë herë për shkak të mirësive dhe shpërblimeve që do të marrin në xhenet." (Buhari, Iman, 26; Muslim, Imare, 103.)

Në ajetin 69 të sures Nisa, thuhet:

"...Dëshmorët në ahiret do të jenë bashkë me pejgamberët, me të singërtët dhe me të devotshmit."

Dëshmorë të vërtetë quhen ata njerëz që kanë luftuar dhe janë vrarë në rrugë të Allahut Teala për lartësimin e fjalës së Tij. Në të njëjtën kohë, është edhe termi "Shehedatu hukmije", domethënë, martirizim juridik. Myslimanët që vdesin në fatkeqësitë që shkaktojnë tërmetet, zjarret dhe përmbytjet, që vdesin në ujë duke u mbytur, që vdesin nga kolera, nga murtaja dhe nga veremi, që vdesin nga erozioni dhe në rrugë të dijes, quhen dëshmorë sipas dispozitave të Islamit. (Shik. Buhari, Xhihad, 30. Tib)

Nëse njeriu dëshiron me zemër që të bjerë dëshmor, Allahu Teala e fut robin e Tij ndërmjet dëshmorëve të vërtetë ose ndërmjet dëshmorëve juridikë... Nëse robi lutet me singëritet dhe insistim për ta dhënë frymën e fundit si dëshmor, Allahu Teala e fut atë rob ndërmjet dëshmorëve edhe nëse merr abdes, shtrihet në shtrat dhe jep frymën e fundit.

Këto janë çështje që i di vetëm Zoti xhelle xhelaluh!.. Neve nuk na ka hije që të bëjmë llogari të tilla. Neve na ka hije t'i lutemi Allahut Teala në një mënyrë të singërtë që të biem dëshmorë pa kushte!.. Pastaj Allahu vepron me ne, ashtu siç dëshiron Ai vetë! Lutja është

nga robi, përgjigja është nga Allahu Teala. Edhe mënyra e përgjigjes, është e panjohur për dijen tonë. Në këtë çështje, rob i takon që të përpiqet shumë dhe sa më singërisht. Si gjithmonë, duhet të kërkojmë te dera e Allahut të Madhëruar me një ndjenjë ndërmjet "haufit" dhe "raxhesë" (frikës dhe shpresës). Jo plotësisht i sigurt nga vetja, por as edhe i pashpresë...

Prej edukatës së robit është edhe kjo lutje:

"O Zot! Unë të besoj Ty. Të lutem më jep atë që është më e mirë për mua!..."

Lutja më e madhe, kërkesa më fisnike që mund të bëjmë për vete dhe për të dashurit tanë që nga momenti i parë kur arrijmë pjekurinë, është kërkesa për të rënë dëshmor. Duhet të kërkojmë aq shumë nga zemra, në mënyrë që Allahu Teala të na mundësojë një jetë në këtë botë që u ka hije dëshmorëve inshallah!..

Prindërit duhet t'i çojnë për vizitë fëmijët e tyre në varrezat e dëshmorëve. Veçanërisht duhet t'i shëtisin në varrezën e dëshmorëve të Çanakkalesë!.. Ata duhet t'u tregojnë fëmijëve historitë e atyre dëshmorëve, historitë e dëshmorëve të Bedrit, historitë e dëshmorëve të Uhudit!...

Fëmijët tanë kanë nevojë t'i mësojnë këto histori, në mënyrë që të jetojnë një jetë me kuptim në rrugë të Allahut!.. Ata duhet ta dinë se përpjekja në rrugë të Allahut Teala është mirësia më e madhe dhe duhet të kenë koncepte për jetën larg dashurisë së kësaj bote, në mënyrë që ta presin vdekjen me një qetësi shpirtërore ashtu siç e dorëzojnë frymën e fundit sorkadhet pa bërë zë në gojën e luanit!..

Pastaj, me aq sa mësova, britma që gruaja e moshuar nxirrte atë natë duke thënë: "Nuk dua të vdes!..", ua shtoi fëmijëve frikën e vdekjes. Frika e fëmijëve të lagjes nga vdekja, mund të hiqet vetëm nëse në zemrat e tyre vendoset në një mënyrë të plotë termi i martirizimit dhe nëse bëhet një jetë me devotshmëri e me ndjenjën e përgatitjes për vdekjen. Lutemi nga zemra pa ndonjë dyshim apo mëdyshje:

"O Zot! Na mundëso që të biem dëshmorë!.. Jeta dhe vdekja jonë, le të jenë vetëm për Ty!.. Amin."



Pozita e dëshmorit

Njeriu gjithmonë dëshiron më të mirën e mundshme... Ne përpiqemi shumë për dëshirat provizore që do t'i lëmë në këtë botë mashtruese kur t'i mbylлим sytë dhe të na mbarojë fryma... Por, a na ka rënë ndonjëherë ndër mend të kërkojmë vdekjen më të mirë? Kurrë!.. Nefsi sillet sikur nuk do të vdesë kurrë... Askush nuk e mendon vdekjen për veten e tij, nuk ka një imazh në lidhje me të, madje nuk mendon aspak për të.

Në ajetin 35. të sures Enbija thuhet:

“Çdo njeri do ta shijojë vdekjen! Ne ju vëmë në provë me të keqe dhe me të mirë dhe te Ne do të ktheheni.”

Pra vdekjes nuk mund t'i ikësh. Frika nuk bën dobi ndaj exhelit. Në të vërtetë vdekja nuk është fundi i çdo gjëje, por fillimi i jetës së vërtetë. Ai që e ka pasur të bukur rrugëtimin e kësaj jete, edhe vdekjen e ka të mirë; ai që e ka të bukur vdekjen, e ka të bukur edhe jetën e pafund, pra ahiretin. Bukuria është relative dhe ndryshon sipas personit. Bukuria që përmendet këtu ka të bëjë me përshtatjen e kënaqësisë së Allahut Teala. Gjëja më e

bukur është të jetosh një jetë plot me devotshmëri e besim sipas kënaqësisë së Allahut dhe t'ia dorëzosh shpirtin Atij (xh.xh.), sipas besimit...

Ndërsa vdekja më e mirë është të japësh shpirt në rrugë të Allahut dhe të biesh dëshmor me një frazë tjetër. Pozita e dëshmorit është grada më e lartë pas pozitës së profecisë... Allahu Teala thotë për dëshmorët:

“Kurrsesi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e Allahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre.” (Al-i Imran, 169.)

Ne i kemi frymët të numëruara dhe jeta jonë e kësaj bote do të marrë fund atëherë kur ta ketë caktuar Allahu (xh.xh.). Sidoqoftë, do ta shijojmë vdekjen. Atëherë, përse të mos dëshirojmë vdekjen më të bukur, atë të dëshmorit?

Veç kësaj jo të gjithë e kanë këtë kësmet. Siç e dëshirojmë këtë gjë me fjalë dhe lutje, duhet të përgatitemi për të me jetë të pastër dhe vepra të bukura!.. Siç ka thënë edhe Pejgamberi, (a.s.):

“Siç keni jetuar, ashtu dhe do të vdisni. Siç do të vdisni, ashtu dhe do të ringjallen!..” (Munavi, Fejzu'l-Kadr, V, 663)



Ata që vriten në rrugë të Allahut, bien dëshmorë. Por duhet të bëjmë kujdes në një çështje: I gjithë qëllimi nuk është të vdesësh. Synimi i vërtetë është të mundohemi ta kalojmë të gjithë jetën sipas urdhrave dhe ndalesave të Allahut, të bëjmë çështje e mundur për këtë, madje duke marrë parasysht edhe vdekjen!.. Synimi është të jetojmë dhe të bëjmë të jetohet Islami. Jo të bëjmë heroizma apo grindje e rrëmuja. Nëse vdekja dhe vrasja ka një synim kaq suprem, atëherë ia vlen.

Çdokush që vdes apo vritet në luftë nuk bie dëshmor!.. Dëshmia është e lidhur me besimin dhe qëllimin që njeriu ka në zemër. Pejgamberi (a.s.), në luftën më të tmerrshme, në Uhud tha për njërin nga radhët e ushtarëve të tij:

“Ai është banor xhehenemil!..”

Njëri nga sahabët e nderuar filloi ta ndiqte atë person nga larg dhe pa se ai u plagos në krah dhe bëri vetëvrasje me shpatën që mbante në dorë. Ai i shkoi pranë në çastet e fundit të jetës dhe e pyeti për shkakun e vetëvrasjes. Ai i tha:

“Unë dola në luftë për të mbrojtur kopshtin tim në Medinë dhe për të mbledhur plaçkën e luftës. Kur u plagosa, nuk munda ta duroj dhimbjen e krahut dhe zgjodha vetëvrasjen!..” (Shik. Vakidi, I, 263)

Domethënë se nuk mjafton për të qenë shëhid (dëshmor) as pjesëmarrja në ushtrinë e Pejgamberit, (a.s.), në luftërat më të tmerrshme!.. Domethënë se para çdo gjëje njeriu duhet të ketë besimin të fortë dhe nijetin të pastër.

Në një tjetër hadith kudsî të Pejgamberit, (a.s.), tregohet se disa dëshmorëve të cilët kishin dalë përpara Allahut Teala, nuk u ishte pranuar dëshmia për shkak se ata kishin shkuar në luftë vetëm që njerëzit të thoshin: “Luftoi si një hero i vërtetë!”. (Muslim, Imare, 152)

Kështu grada e dëshmorit është një gradë që nuk mund të arrihet lehtë!.. Zemra duhet të përgatitet një jetë të tërë për këtë.

Pas një përpjekjeje adhurimi dhe sinqeriteti që zgjat gjatë gjithë jetës, edhe nëse nuk bëhet luftë, edhe nëse personi vdes në shtratin e butë, ai përsëri shkruhet në radhën e dëshmorëve. Këtë përgëzim e ka dhënë edhe Pejgamberi, (a.s.):

“Kushdo që kërkon me sinqeritet nga Allahu Teala që të bjerë dëshmor, edhe nëse vdes në shtrat, Allahu, xhelle xhelaluh, i jep atij gradën e dëshmorit.” (Tirmidhi, 1705; Ebu Davud, 2541; Ibn-i Maxhe, 2797)

Falënderuar qoftë Allahu, tani në vendin tonë nuk ka luftë, por ka një sulm të pamëshirshëm. Po, madje sulme që vazhdojnë e shtohen dita ditës... Jo me dyfekë, armë apo shigjeta... Me armët moderne, televizorin dhe internetin; ka një sulm nga brenda,

apo me një shprehje tjetër: “Pa rënë në sy.”

Një sulm i tillë për të cilin nuk jemi në dijeni dhe jo që nuk mund ta luftojmë, por nga i cili madje nuk mund as të mbrohemi...

Kanë thënë:

“Për të shkatërruar një popull, së pari duhet t’i shkatërroi kulturën!..”

Ne patëm një kulturë, njeri, civilizim, miqësi, besim, moral, familje të fortë si uragan. Çdo ditë kultura dhe identiteti ynë po këputet fije pas fijeje. Madje pa e ndjerë aspak... Humanizmi, morali, dija dhe njohuria jonë dita-ditës po tronditen. Vlerat që na bëjnë të jemi vetvetja dhe që na mbajnë të lidhur me njëri-tjetrin po shkatërrohen me goditje të lehta nga dyar mjeshtërore.

Atëherë çfarë presim? A dëshirojmë të bëhemi dëshmorë? Ky është rast që na ka dhënë Allahu, ta shfrytëzojmë pra!.. Jo me topa e dyfekë, por do luftojmë me besimin që kemi në zemra, me dijen që kemi në personalitetin tonë, me njohuri, inteligjencë e moral të lartë. Do të luftojmë deri në fund pa kompensuar asgjë që bie ndesh me fenë, kulturën dhe spiritualitetin tonë. Më parë luftërat bëheshin duke u përballur ushtritë. Ndërsa tani bëhen mbi tavolinë, me televizorë, serialë e filma, muzikë madje edhe me lojëra...

Sigurisht që vjen një ditë dhe me anë të një butoni bombat bien mbi një qytet, mbi një shtet, por deri atëherë armiku atë vend e ka shkatërruar përbrenda... Madje popujt vijnë në një pikë ku thonë: “Sa mirë që hodhët bomba në vendin tonë, përndryshe kushedi sa keq do e kishim gjendjen?!”... Ata ndjejnë një admirim të madh ndaj armikut i cili i bombardoi dhe i shkatërroi. Ja, kjo tregon se ata shumë më përpara e kanë humbur në të vërtetë luftën në zemrat e tyre.

Atëherë luftërat fillojnë në zemër dhe po aty mbarojnë. Ai që e fiton luftën në zemrën e tij, e fiton edhe në fushëbetejë. Ai që bie rob në zemrën e tij, e godet edhe kokën me zinxhirë.

A dëshirojmë që të luftojmë në rrugë të Allahut dhe të biem dëshmorë? Kjo nuk ka nevojë për topa e dyfekë. Nuk ka nevojë ta kërkojmë larg armikun!.. Armiku ka pushtuar brendësinë tonë, shtëpinë tonë, madje edhe të afërmit tanë... Nëse duam t’ia fillojmë nga diku, së pari t’ia fillojmë nga vetja jonë!.. Nga shtëpia jonë, të afërmit tanë, lagjja jonë... T’i pastrojmë ata nga papastërtitë. Të rregullojmë zemrën, nijetin tonë dhe atëherë do të shohim se para nesh do të hapen shumë dyer!..

Robërit të cilët luten për të rënë dëshmorë!.. Dëshmia nuk është larg!.. Ata që e jetojnë jetën si “dëshmorë”, edhe vdekjen e kanë si ata!..

Gratë

që janë kurorëzuar me martirizim

*Në kohën e drekës kur dielli digjte më shumë,
vendoseshin nga mizorët në rërën e nxehtë,
lidheshin pas deveve dhe tërhiqeshin zvarrë. Ua
damkosën trupat me shkëmbinj që ndizeshin flakë.
Por kurrë nuk i kthyen nga besimi që kishin.*

Sumejja (r.a.), ishte sahabeja e parë në Islam që u martirizua...

Nëna e Ammar ibn Jasirit (r.a.)...Me gjithë rënkimet nën torturat e mushrikëve bashkë me gjithë familjen, bashkëshortin Jasirin dhe djalin, ata qenë luftëtarët e parë të cilët nuk e lëshuan besimin e tyre... Guximtarë që morën parasysh të vdisnin me nder në rrugë të Allahut dhe Pejgamberit (a.s.)...

Një familje besimtare që u përpëliti për të mos rënë në shirk dhe qëndroi me durim kundrejt shtypjeve dhe mizorive... Familja e parë e vuajtur në Islam... Dëshmorët e parë që dhanë jetën në rrugë të Allahut dhe të Dërguarit të Tij...

Sumejje binti Habbat ishte robëresha e Ebu Huzejfe ibn Mugire nga bijtë e mahzumëve. Atë e donin shumë për shërbimin që bënte. Ebu Huzejfe e martoi me Jasirin. Jasiri ishte një djalosh që kishte ardhur nga Jemeni në Mekë dhe ishte strehuar e punonte te Ebu Huzejfe. Kur u bë me fëmijë, e la të lirë Jasirin.

Nga kjo martesë erdhi në jetë sahabiu i madh, Ammar bin Jasiri (r.a.). Ditët e para të Islamit banorët e kësaj familjeje fatlume të gjithë bashkë u nderuan me Islam dhe u bënë sakrifikues të besimit. Ata ranë pre e torturave të tmerrshme të mushrikëve të tërbuar. U torturuan në mënyrën më mizore ngaqë në Mekë nuk kishin asnjë që t'i mbronte. Ata u shtypën rëndë nga mushrikët, duke filluar që nga bijtë e mahzumëve.

Në kohën e drekës kur dielli digjte më shumë, vendoseshin nga mizorët në rërën e nxehtë, lidheshin pas deveve dhe tërhiqeshin zvarrë. Ua damkosën trupat me shkëmbinj që ndizeshin flakë. Por kurrë nuk i kthyen nga besimi që kishin.

Familja Jasir dha shembullin më të mirë në lidhje me vendosmërinë në besim. Edhe pse u kushtoi jetën, ata treguan se lumturia më e madhe ishte besimi te Allahu dhe i Dërguari i Tij (a.s.). Burrë e grua ranë dëshmorë. Jasiri, (r.a.) dhe Sumejja, (r.a.), kaluan në faqet e ndritura të historisë si dëshmorët e parë të Islamit.

Një ditë Pejgamberi, (a.s.), shkoi te vendi ku torturohej kjo familje heroike. Kur panë nga larg se po vinte i Dërguari i Allahut (a.s.), ata i harruan dhimbjet dhe filluan të shikonin drejt Tij. Nuk i ndanë aspak sytë nga Ai (a.s.), sikur donin ta mirëprisnin. Nuk menduan për torturat që u bëheshin dhe u qetësuan me gëzimin se e panë Atë (a.s.).

Kur u afrua, Pejgamberi i mëshirës, u dha këtë përgëzim, i cili do të shtonte tek ata qëndresën, do t'u jepte forcë për të duruar në lidhje me besimin, do t'i ngushëllonte për vuajtjet dhe do të bëhej shkak për qetësim:

“Duron i o familja Jasir! Duroni o familja Jasir! Ju përgëzoj me xhenet.”

Duke u premtuar xhenetin vuajtësve të parë të

Islamit, u tregoi si qëllim Darusselamin (vendi ku do të preheshin në paqe). Por njeriu ishte i paaftë, ishte krijuar i dobët.

Kështu do të kalonin ditët gjithmonë, në tortura? Jasiri, (r.a.), pyeste vazhdimisht në një dorëzim të madh:

“O i Dërguari i Allahut! A kështu do të kalojë gjithmonë koha?”

Pejgamberit, (a.s.), i qante zemra. Torturat që u bëheshin atyre, i ndjente në zemër sikur po i bëheshin Atij (a.s.), por si njeri duhet të bëhej një përpjekje. Ai u kërkoi të qëndronin duke u lutur:

“O Zot, lësho mëshirë mbi familjen Jasir!..”

Ai u mundua t’i qetësonte në këtë mënyrë.

Kaluan disa ditë dhe torturat vazhdonin. Jasiri (r.a.), ishte i moshuar. Ai nuk u duroi më shumë vuajtjeve dhe e dorëzoi shpirtin. Jasiri (r.a.), ishte i pari që pati fatin të binte dëshmor në luftën e besimit në rrugë të Allahut dhe Pejgamberit (a.s.).

Xhaxhai i Ebu Xhehlit, Ebu Hudhejfe, pas martirizimit të Jasirit, donte ta shfrynte të gjithë zemërimin të Sumejja dhe djali i saj Ammari. I lodhur dhe i dërmuar nga mizoria, i tha xhaxhait të tij, Ebu Xhehlit:

“Punën e Sumejjes po ta lë ty.”

Ebu Xhehli, i tërbuar nga mllefi e mendjemadhësia, u kthye nga Sumejja (r.a.), si një egërsirë dhe e shau me inat:

“Ti e besove Muhamedin, ngaqë u dashurove pas bukurisë së tij.”

Nëna jonë Sumejja iu përgjigj atij njeriu të shturur duke i thënë fjalë të rënda. Ebu Xhehli u tërbua. Nga fjalët që dëgjoji dhe që iu kthyen në pështyma drejt tij, mushriku i egër e mizor e bëri dëshmore nënën tonë të nderuar Sumejjen me heshtjen që kishte në dorë.

Çfarë besimi!.. Çfarë durimi!.. Çfarë qëndrese!.. Dhe ç’fund i bukur!.. Çfarë guximi kundrejt mizorit!.. Çfarë heroizmi duke klithur kudo për të mbrojtur të drejtën!.. Sa forcë e madhe është besimi!.. Zemra pa besim me të vërtetë është barrë e krahavorit!.. O Zot, na bëj edhe ne sakrifikues në besim!.. Na mundëso

që të mbajmë të drejtën dhe të mund të durojmë për të!.. Na bëj prej atyre që e jetojnë besimin dhe arrijnë te Ti me besim!..Amin.

Sumejje, (r.a.), është trimëreshë besimtare, e cila pati fatin të ishte dëshmorja e parë grua në Islam. Një nënë heroike e cila bëri bujë me sakrificën që bëri në rrugë të Islamit dhe që dha shpirtin për Allahun dhe Pejgamberin (a.s.)...

Kur djali i Sumejjes (r.a.), Ammar bin Jasiri (r.a.), shpëtoi nga torturat, shkoi te Pejgamberi, (a.s.) dhe i tha se ishte shumë i mërzhitur që nëna e tij kishte rënë dëshmore në një mënyrë të dhimbshme dhe se tashmë nuk i kishte ngelur durim për mizoritë që u bëheshin. I Dërguari i Allahut, (a.s.), e këshilloi Ammarin (r.a.), të bënte durim dhe u lut:

“O Zot! Mos e ndëshko me zjarr asnjë nga familja Jasir.”

Mushriku i tërbuar, Ebu Xhehli, i cili u cilësua nga umeti si faraoni, u vra në luftën e Bedrit. Pejgamberi i mëshirës, (a.s.), atë ditë i tha Ammarit (r.a.):

“Allahu Teala e vrau vrasësin e nënës tënde.”

Allahu e shtoftë mëshirën për këtë familje sakrifikuese dhe na mundësoftë ne të gjithëve të marrim nga dashuria e tyre për përpjekje, durim, qëndrim dhe të arrijmë ndërmjetësimin e tyre! Amin. (Mustafa Erish, Gratë Sahabe-2)

Në luftën e Bedrit pati nga ato gra që kërkuan të luftonin përkrah me burrat. Ummu Varaka, që ishte njëra nga këto gra, vrapoi për te Pejgamberi, (a.s.) dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Më lejoni të mjekoj plagët dhe të kujdesem për të sëmurët. Ndoshta Allahu më mundëson të bie dëshmore!”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

“Qëndro në shtëpi dhe lexo Kuran! Patjetër që Allahu ta bën rizk martirizimin!”

Më vonë Ummu Varaka u bë e famshme mes sahabeve me emrin “Dëshmorja”. Edhe ajo kishte një dëshirë të madhe për martirizim. Më në fund ajo u





martirizua nga disa kriminelë në kohën e Omerit. Kur Omeri, (r.a.), e dëgjoi këtë, tha:

“I Dërguari i Allahut na këshillonte që ta vizitonim shpesh “Dëshmoren”. Paska qenë e vërtetë!..” (Osman Nuri Topbash, Nebiler Silsilesi-4)

Në kohën e Pejgamberit, (a.s.), vajza e Amrit, poetja e shquar Hansa, shkruante poezi shumë të bukura për heroizmin. Pasi u bë myslimane, Islami e bëri atë shembull të një sakrifice të lartë dhe një besimi të përsosur. Edhe pse në luftën e Kadisijes i ranë dëshmorë katër djemtë, kurrë nuk e humbi durimin dhe nuk u tundua. Duke e ruajtur ndjenjën e Islamit, ngushëllimi që i jepte të qenit nënë dëshmori, e kishte bërë ta harronte dhimbjen e bijve.

Poetja Hansa shkoi në fushën e luftës dhe i entuziazmoi bijtë e saj me këto fjalë historike:

“Bijtë e mi heronj,

Betohem se ju jeni fëmijë nga të njëjtët prindër. Unë jam një grua që nuk e ka tradhtuar kurrë burrin e saj, po ashtu edhe babai juaj është një njeri me një të kaluar të pastër. Unë e pranova Islamin jo me imponim, por me shumë dëshirë dhe me dëshirën time bëra hixhret.

Ja, ju keni një të kaluar krejt të pastër. Ju kërkoj që të hyni në luftë me një guxim dhe trimëri që i përshtatet kësaj fisnikërie; të jeni të parët që i sulen armikut; nuk dua t’ju shoh të luftoni në radhët e pasme, por gjithmonë në radhët e para, sepse kjo luftë nuk është vepër lajkatare që bëhet për përfitime të rëndomta siç bënin luftëtarët e mëparshëm. Është një vepër e cila u tregon të vërtetën dhe të drejtën idhujtarëve të cilët adhurojnë idhujt që i bëjnë vetë dhe të cilët e vazhdojnë egërsinë e tyre aq sa të varrosin të gjalla bijat e tyre. Shkurtimisht, në këtë xhihad urdhri është nga Allahu dhe komanda nga Pejgamberi, (a.s.).

Ç’nevojë ka për më shumë fjalë!?”

Pas këtyre fjalëve poetja Hansa i përqafoi një nga një bijtë e saj dhe shtoi:

“Ose valëviteni flamurin e fitores së Islamit në Kadisije, ose të dëgjoj se keni rënë dëshmorë duke luftuar në rrugë të fesë!..”

Ky fjalim heroik i një nëne drejtuar bijve të saj, i entuziazmoi edhe luftëtarët e tjerë që gjendeshin aty dhe u bë shkak që të valëvitej në Kadisije flamuri i fitores së Islamit.

Pikërisht ashtu ndodhi. Ndërsa ishte e sëmurë në shtrat, i erdhi lajmi i martirizimit të katër bijve. Ajo pyeti:

“Domethënë unë jam bërë nënë dëshmori?”

“Po”, i thanë “Madje nënë e katër dëshmorëve...”

Pastaj pyeti.

“Cilët janë fitimtarët?”

“Fituan myslimanët... Tani në Kadisije valëvitet flamuri i Islamit!..”

Hansa tha:

“Kurban u bëfshin bijtë e mi për një fitore të Islamit!..”

Pastaj ngriti duart dhe u lut:

“O Zot! Katër heronj të cilët mi bënë amanet, i sakrifikova përsëri në rrugë të fesë tënde. Tashmë më shkruaj në radhët e nënave të dëshmorëve!..Më mjafton si dhuratë të jem nënë dëshmorësh. Ma mundëso këtë!..”

Sa herë që flitej për Hansën, i Dërguari i Allahut, (a.s.), thoshte:

“Një grua shembull e Islamit...”

Sumejra, kur dëgjoi lajmin e humbjes së myslimanëve në luftën e Uhudit, u mërzi shumë. Në luftë kishin marrë pjesë babai, burri, vëllai dhe dy djemtë e saj. Vallë, në çfarë gjendjeje ishin? Edhe për Pejgamberin, (a.s.), kishte dëgjuar shumë fjalë. Ishte shumë e shqetësuar. Për të mësuar në të vërtetë se ç’i kishte ndodhur Pejgamberit, (a.s.), shkoi bashkë me një grup sahabesh në Uhud.

Kur Sumejra hyri në fushën e luftës, mësoi se babai, burri, vëllai dhe djali i saj kishin rënë dëshmorë. Madje pa trupat e tyre të cilët ishin copëtuar nga goditjet e shigjetave dhe shpatave. Sahabët e ngushëllonin Sumejran dhe e këshillonin të bënte durim. Në këtë mënyrë mundoheshin ta qetësonin. Ndërsa ajo qëndronte e fortë dhe pyeste me këmbëngulje për gjendjen e Pejgamberit, (a.s.). Donte të njoftohej për shëndetin dhe gjendjen e Tij. Sahabët të cilët i uronin durim, i pyeste:

“Çfarë bën i Dërguari i Allahut? Si është Ai?”

Sahabët e nderuar donin të ndanin me të dhimbjen,

ndërsa ajo donte sa më parë të shikonte Pejgamberin, (a.s.).

Sahabët të cilët ishin të admiruar nga dashuria e madhe e Sumejrës, i përgjigjeshin pyetjeve të saj:

“Ai është mirë, falënderuar qoftë Allahu. Është ashtu siç dëshiron ti.”

Vetëm se të gjitha këto përpjekje nuk mund ta qetësonin brengën që kishte në zemër. Ajo dëshironte ta shikonte me sytë e saj Pejgamberin, (a.s.). Sytë e saj kërkonin vetëm Atë në fushën e luftës.

Sumejra pothuajse u përgjërohej sahabëve, të cilët mundoheshin ta qetësonin:

“Ma tregoni vendin ku ndodhet. Ma tregoni që ta shoh njëherë!”

Kur sahabët i bënë me shenjë vendin ku ndodhej Dielli i dy Botëve, Sumejra u drejtua menjëherë andej. Shkoi atje duke vrapuar. Kur pa se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ishte gjallë, e falënderoi Allahun dhe tregoi mallin dhe dashurinë e thellë në zemër duke thënë:

“Nëna dhe babai im të qofshin falë o i Dërguari i Allahut! Vetëm Ti të jesh gjallë dhe unë nuk pyes për asnjë fatkeqësi!..”

Me fjalët “Vetëm Ti të jesh gjallë” tregoi se çdo gjë, çdo dhimbje, çdo brengë në botë është e parë-

ndësishme. Ja, kështu e donin ata Pejgamberin, (a.s.). A nuk ishte kjo që i kthente në yje dhe i bënte të paarritshëm sahabët?

Ç’dashuri e thellë!.. Ç’besim i fortë!.. Çfarë malli!.. Çfarë amaneti!.. Çfarë durimi!.. Çfarë dorëzimi!.. Çfarë shembulli i bukur!..

O Zot, na e dhuro edhe neve atë dashuri!.. Na e forco besimin dhe na i zbukuro veprat!.. Na mundëso që gjithmonë ta kemi primare në zemër dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij!.. Na mundëso që të marrim nga këto sjellje shembullore të sahabëve të nderuar!.. Na bëj të gjithëve të arrijmë ndërmjetësimin e Semejras (r.a.)!.. Amin (Mustafa Erish, Gratë Sahabe)

Pejgamberi, (a.s.), ka thënë:

“Të dëshmorit ka shtatë veçori:

1- Në pikën e parë të gjakut, i falen të gjitha mëkatet.

2- E shikon pozitën e tij në xhenet.


3- Martohet me shtatëdhjetë hyri në xhenet.

4- I shpëton ndëshkimit të varrit.

5- Është i sigurt nga dita e tmerrshme e llogarisë.

6- I vendoset në kokë kurora prej rubini e ndershmërisë.

7- Ndërmjetëson për shtatëdhjetë njerëz nga eбли bejti.”
(M. Sami Ramazanoglu, Lufta e Uhudit, sh: 52)



Një ditë të premte nuk munda ta arrija kohën e namazit në Haremin e Mekes dhe u detyrova ta fal namazin në një xhami të vogël në lagje. Në minberin e kësaj xhamie të vogël po predikonte një imam hijerëndë i mbështetur në bastun. Fjalët që tha në hytbe, pas shumë vitesh madje akoma më buçasin në vesh:

“...Ata që duan të mësojnë se si e nderon Allahu Teala një popull që lufton për hir të Tij dhe si e poshtëron kur heq dorë nga ajo rrugë, të shikojnë popullin turk. Shikoni, kur ata luftonin në rrugë të Allahut, dërgonin në këtë kontinent guvernatorë dhe komandantë të shquar. Kur hoqën dorë së luftuari në rrugë të fesë së Allahut, filluan të dërgonin njerëz që punojnë me kazmë e lopatë. Ky ndryshim madhështor shpjegohet vetëm ngaqë ata hoqën dorë nga xhihadi në rrugë të Allahut...”

Imami tha edhe shumë fjalë të tjera, por për mendimin tim ky shembull i fjalimit të tij ishte një paralajmërim që vliente sa vetë bota. Meqë unë isha një turk mes atij xhemati, ndërgjegjia ime u detyrua t’i konfirmonte fjalët e atij imami. (Kadir Mësërollu, İthafı Fıkralar, Sebil Yayınları)

Kush janë dëshmorët?

Një emër fisnik i Allahut Teala është edhe “Esh-Shehid”, që do të thotë: “Që dëshmon për çdo gjë, është në dijeni, vështrohet dhe di të qartën dhe të fshehtën e çdo gjendjeje”. Kjo cilësi hyjnore në ajetin 32 të sures Nisa shprehet:

“... Vërtet, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.”

Ndërsa në ajetin 6 të sures Muxhadile thuhet:

“... Allahu të gjitha i ka shënuar, edhe pse ata i kanë barruar. Allahu është dëshmitar i çdo gjëje.”

Kuptimi tjetër i fjalës “shehid” është: Robërit e Allahut Teala që janë mëkëmbësit e Tij në tokë, të ruajnë të drejtën dhe drejtësinë e Allahut, të përpiqen që ta bëjnë sunduese atë në tokë dhe të flijojnë qoftë edhe jetën e tyre në këtë rrugë. Në ajetin 111 të sures Teube thuhet:

“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit. Ata luftojnë në rrugën e Allahut, vrasin dhe vriten...”

Allahu Teala që dëshmon duke parë çdo gjë, kërkon nga robërit e Tij besimtarë që të dëshmojnë për Ekzistencën, Njësimin, Fuqinë, Madhësinë, Sublimitetin dhe Drejtësinë e Tij mbi sipërfaqen e tokës. Robi besimtar duhet ta dëshmojë këtë të vërtetë në jetën e kësaj bote me fjalët, veprat dhe mënyrën e tij të jetesës dhe duhet t’i dorëzohet urdhrin e Allahut Teala. Deri sa të mundohet e të përpiket të sakrifikojë në këtë çështje edhe shpirtin që e mban gjallë.

Të hidhet pa iu trembur syri në zjarr për të mbrojtur njësimin e Allahut si Ibrahim, ta vërë kokën poshtë thikës me nënshtrim ndaj urdhrin të Zotit si Ismaili, të ecë pa u shqetësuar dhe me mbështetje të Allahut në ujërat e thella të Detit Të kuq si Musai. Si shpërblim për këto Allahu Teala jep këtë përgëzim:

“Kursesi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e Allahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre. Janë të gëzuar për çfarë u ka dhënë Allahu nga dhuntitë e Tij dhe gëzohen edhe për ata që ende nuk u janë bashkuar e që kanë ngelur pas tyre (dhe ende nuk kanë rënë martirë), sepse nuk do të frikësohen (për çfarë i pret) dhe nuk do të pikëllohen (për çfarë kanë lënë pas).” (Al-I Imran, 169-170)

Duke parë dëshminë të cilën tregon ajeti fisnik, martirizimi, përfundimi i dhimbshëm i jetës së kësaj

bote, nuk është një vdekje pa synim. Ajo, përkundrazi, është fillimi i një ringjalljeje. Kjo është edhe për ata që kanë pirë sherbetin e martirizimit, edhe për ata që kanë ngelur pas...

Si përfundim jeta e kësaj bote është një vend provimi. Allahu Teala e ka krijuar botën dhe çfarë ka në të për të sprovuar njerëzit se cilët do të bëjnë vepra më të mira. Sigurisht që njeriu i cili jeton duke dëshmuar për bukurinë e fesë së Allahut, qëllimin më të madh të jetës duhet të ketë kurorëzimin e fundit të jetës me shehadet.

Në këtë kuptim shehadeti (martirizim) do të thotë sakrifikim i çdo gjëje, madje edhe i shpirtit në rrugë të Allahut. Pra shehadeti është bërja kurban e amanetit më të shtrenjtë, për atë që do më shumë.

Martirizimi është më i vlefshëm se çdo pasuri e mbledhur në këtë botë. Në ajetin fisnik thuhet:

“Edhe nëse ju vriteni ose vdisni në udhë të Allahut, falja dhe mëshira e Allahut, me të vërtetë, janë më të mira nga ato që kanë grumbulluar ata.” (Al-i Imran, 157)

Pejgamberi, (a.s.), thotë për gjendjen në xhenet të klasës së veçantë të këtyre dëshmorëve:

“Shpirtrat e vëllezërve tanë shehidë (dëshmorë) sillen në xhenet me zogj të gjelbër. Ata pinë ujë nga burimet e xhenetit, hanë nga frutat e tij, shkojnë në hijen e arshit me kandila të artë e të varur dhe qetësohen. Kur shijojnë ushqimet, pijet dhe bukuritë që përjetojnë atje, thonë:

‘Sikur vëllezërit tanë ta dinin se çfarë na ka dhënë ne Allahu Teala dhe të mos tërhiqeshin nga lufta.’” (Ebu Davud, Xhihad, 27/2520.)

Kjo pozitë e privilegjuar të Allahut, është vetëm për ata që luftojnë në luftëra dhe bien dëshmorë duke luftuar me armikun? Apo quhen shehidë edhe njerëz të tjerë? Ky transmetim që vjen për këtë çështje nga Pejgamberi (a.s.), është shumë mësimdhënëse:

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i pyeti një ditë sahabët:

“Cilin pranoni si dëshmor në mesin tuaj?”

Sahabët e nderuar i thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Shehid është ai që vritet në rrugë të Allahut.”

Pejgamberi (a.s.), tha:

"Padyshim, atëherë shëhidët e umetit tim janë pak."

Pas kësaj, sahabët e pyetën:

"Atëherë kush janë dëshmorët, o i Dërguari i Allahut?"

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), tha:

"Ai që vritet në rrugë të Allahut, është dëshmor. Edhe ai që vdes në rrugë të Allahut, është dëshmor. Ai që vdes nga murtaja, është dëshmor. Ai që vdes nga sëmundjet e barkut, është dëshmor. Edhe ai që vdes duke u mbytur në ujë, është dëshmor." (Muslim, Imara, 165)

Pejgamberi, (a.s.), edhe në kohë të tjera këtyre shëhidëve u kishte shtuar:

1. Ai që vdes në rrugë të Allahut, është dëshmor

Pejgamberi, (a.s.), ka thënë:

"Kushdo që del nga shtëpia në rrugë të Allahut, vdes, ose vritet, ai është dëshmor. E rrëzon kali apo deveja (i thyejt qafa), e pickon ndonjë akrep apo gjarpër, ose vdes në shtrat në një mënyrë që e dëshiron Allahu Teala, padyshim se ai njeri është dëshmor dhe patjetër që për të ka xhenet." (Ebu Davud 1/391; Hakim 2/78; Bejhaki 9/166.)

2. Ai që vdes nga veremi, është dëshmor

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

"... Të vdesësh nga veremi është një martirizim." (Taberani, Mu'cemu'l-Evsat, Mecmau'z-Zevâid, 317.)

3. Ai që vdes poshtë rrënojave, është dëshmor

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

"...Ai që vdes poshtë rrënojave, është dëshmor..." (Buhari, Xhihad, 30)

4. Ai që vdes duke u djegur, është dëshmor

Pejgamberi, (a.s.), ka thënë:

"...Kush vdes duke u djegur, është dëshmor..." (Muvatta, 232-233; Ebu Davud 3111; Muslim 1914/164)

5. Ai që vdes duke u mbytur në ujë, është dëshmor

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

"...Të vdesësh duke u mbytur në ujë, është një martirizim..." (Muslim, Imare, 165)

6. Ai që vdes për pasurinë e tij, është dëshmor

Një burrë erdhi te Pejgamberi (s.a.s.) dhe i tha:

"O i Dërguari i Allahut!.. Nëse dikush vjen të më marrë pasurinë, çfarë të bëj?"

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

"Mos ia jep atij pasurinë tënde!.."

Burri e pyeti:

"Po nëse rrihet me mua?"

Pejgamberi, (a.s.), i tha:

"Rrihu edhe ti me të!"

Burri përsëri pyeti:

"Po nëse më vret!"

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), i tha:

"Atëherë ti je një dëshmor!.."

Burri e pyeti:

“Po nëse unë e vras atë?”

Pejgamberi, (a.s.), i tha:

“Ai është në xhebenem!..” (Muslim, Imare, 225.)

7. Ai që vdes për familjen e tij, është dëshmor

Pejgamberi, (a.s.), ka thënë:

“...Kushdo që vritet për familjarët e tij, ai njeri është dëshmor...” (Ebu Davud, Sunnet, 29.)

8. Kush vdes në rrugë të fesë, është dëshmor

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“...Kushdo që vritet në rrugë të fesë, ai njeri është dëshmor...” (Ebu Davud, Sunnet, 29.)

9. Ai që vdes duke parandaluar padrejtësinë që i bëhet, është dëshmor

Pejgamberi, (a.s.), ka thënë:

“Personi që vritet ndërkohë që është duke parandaluar padrejtësinë që po i bëhet, është dëshmor.” (Nesei, 173-174; Ahmed bin Hanbel, 2780.)

10. Ai që vdes në rrugë të Allahut duke mbrojtur kufijtë, është dëshmor.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Të ruash kufirin një ditë e një natë, është më e vlefshme se një muaj agjërim dhe namaz nafle. Nëse ai person vdes në shërbim, vazhdojnë t'i shkruhen risku dhe veprat e mira që ka bërë, po ashtu në Ditën e Kiametit ringjallet si dëshmor.” (Muslim 1913/163; Tirmidhi; Ebu Davud 2500.)

11. Ai që vdes në shtrat duke dëshiruar rënien dëshmor, është dëshmor

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Kush kërkon nga Allahu me zemër të singertë që të bjerë dëshmor, Allahu e lartëson atë njeri në gradën e dëshmorëve, edhe nëse vdes në shtratin e tij.” (Muslim, Imare, 157.)

12. Ai që plagoset në luftë dhe pastaj vdes, është dëshmor

I Dërguari i Allahut, (a.s.), vizitoi birin e vëllait të Xhebr Ensariut kur ishte sëmurë. Të afërmit filluan të qajnë për të. Xhebr Ensariu, (r.a.), tha:

“Mos e lëndoni të Dërguarin e Allahut, (a.s.), me zërat tuaj!..” I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

“Lëri ata të qajnë përderisa është gjallë, por të heshtin

kur të vdesë!..”

Njëri prej të afërmeve i tha:

“Ne nuk mendonim se do të vdisje në shtrat ngaqë luftoje në rrugë të Allahut bashkë me të Dërguarin e Allahut!” Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

“A bie dëshmor vetëm nëse vritesh në rrugë të Allahut?! Atëherë, dëshmorët e umetit tim janë të pakët. Edhe vdekja pasi të plagosesh në luftë është rënie dëshmor...” (et-Terhib ve't-Tergib, 3/248.)

13. Ai që vret sunduesi i padrejtë, është dëshmor

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Më i nderuari i dëshmorëve është biri i Abdulmut-talibit, Hamzai dhe ai njeri që e urdhëron sunduesin e padrejtë për të mirë dhe e ndalon nga e keqja dhe vritet për shkak të kësaj.” (Sahihu'l-Xhamii's-Sagir, 3675.)

14. Ai që vdes në kohën e fitnes, është dëshmor

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Pas jush, do të vijnë ditët e durimit. Për atë që i përmbahet gjendjes suaj në ato ditë, do të ketë sevapin e pesëdhjetë dëshmorëve prej jush.”

Sahabët e nderuar, e pyetën:



“O i Dërguari i Allahut! Pesëdhjetë dëshmorë prej tyre?”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

“Jo, përkundrazi, prej jush!..” (Sahihu'l-Xhamii's-Sagir, 2234.)

15. Ai që vdes duke mbrojtur Xhaminë Aksa, është dëshmor

I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë:

"Ai që vdes duke mbrojtur Xhaminë Aksa, është dëshmor..." (Terhib ve't-Tergib, 3/250, Ahmed bin Hanbel.)

16. Ajo që vdes për shkak të fëmijës kur është shtatzënë, është dëshmore

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e vizitoi Abdullah bin Revahan, (r.a.), kur prehej i sëmurë në shtrat. Kur Abdullah bin Revaha, (r.a.), i hap vend të Dërguarit të Allahut, (a.s.), që kishte pranë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

"A e dini ju se kush janë dëshmorët e umetit tim?

Sahabët e nderuar thanë:

"Vrasja e myslimanit është martirizim!" I Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

"Atëherë, dëshmorët e umetit tim do të ishin pak!.. Vrasja e myslimanit është martirizim. Të vdesësh nga murtaja është martirizim. Të vdesësh për shkak të fëmijës në bark kur je shtatzënë, është martirizim. Fëmija do ta tërheqë nënën drejt xhenetit me anë të kordonit të tij!.." (Ahmed bin Hanbel, 201, 323)

17. Ajo që vdes përgjatë lehonisë, është dëshmore

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

"Të vdesësh përgjatë lehonisë, është martirizim. Të vdesësh duke u djegur, është martirizim. Të vdesësh duke u mbytur në ujë, është martirizim. Të vdesësh nga veremi, është martirizim. Të vdesësh nga dhimbja e barkut, është martirizim." (Taberani, Mu'xhemu'l-Evsat, Mecxhmau'z-Zevaid 317.)

Edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), e dëshironte shumë martirizimin dhe ka thënë:

"Betohem në Allahun, në dorën e të Cilit është jeta e Muhamedit se ai që plagoset në rrugë të Allahut, do të vijë Ditën e Gjykimit ashtu siç është plagosur. Plaga e tij, do të ketë ngjyrën e gjakut, ndërsa ai do të kundërmojë erë misku. Betohem në Allahun, në dorën e të Cilit është jeta ime se do të dëshiroja të vritesha në rrugë të Allahut, pastaj të ringjallesha dhe të vritesha përsëri, pastaj të ringjallesha dhe përsëri të vritesha..." (Muslim, Kitabu'l-Iman, 103.)



**O Zot! Na tubo edhe ne ndërmjet profetëve,
të singertëve dhe dëshmorëve!.. Sa shokë të mirë që janë ata!..
O Zot! Na e bëj edhe neve kësmet martirizimin
ashtu siç ua ke bërë kësmet robërve të Tu të veçantë!..
Amin.**



Osman Nuri Topbash

Haku i robit

Gjatë Luftës së Çanakalesë, që ka kaluar në faqet e historisë si lufta legjendare e të parëve tanë, në fshatin Koxhadere ishte ngritur një vend, ku u jepej ndihma e parë mjekësore të plagosurve që vinin nga fronti i luftës. Në këtë vend silleshin për mjekim ushtarë nga vende të ndryshme (të Perandorisë Osmane). Dikush ishte prej Urfës, dikush prej Bosnjës, dikush prej Adijamanit e dikush tjetër prej Halepit.¹

Një prej këtyre të plagosurve ishte edhe një ushtar prej fshatit Bejbash të Lapsekisë, i cili kishte një plagë shumë të rëndë. Për shkak të dhimbjeve të mëdha që i jepte plaga, edhe frymën e merrte dhe e jepte me vështirësi. Me qëllim që ta mbante pak gjoksin, i cili ngrihej dhe ulej vazhdimisht nga frymëmarrja, e kapi komandantin për rrobash dhe, pasi mori frymë thellë, nga buzët e tij rrodhën këto fjalë:

“Kam shkruar një pusullë... Ju lutem jepjani shokut tim...” Heshti për pak çaste, me qëllim që të mund të fliste edhe pak. Pastaj mori përsëri frymë thellë dhe, duke u përtypur disa herë, tha këto fjalë:

“Unë... Unë kam marrë 1 mexhite borxh nga fshatari im, nënoficeri Ibrahim... Nuk munda ta takoj përsëri. Mbase më bëhet kështu që ta pi sherbetin e dëshmorit para se ta takoj. Nëse vdes, i thoni atij të ma bëjë hallall.”

Kujdesi ndaj hakut të robit që tregoi ky luftëtar në frymën e tij të fundit, e bënë komandantin t'i mbushej zemra dhe t'i lageshin sytë me lot. Duke falënderuar në vetvete që ka ushtarë të tillë, të cilët dëshirojnë të arrijnë tek Allahu me faqe të bardhë, u mundua që me këto fjalë ta ngushëllonte sadopak:

“Mos ki merak, mor bir. Do ta gjej atë dhe do t'i

1. Në luftën e Çanakalesë morën pjesë luftëtarë nga të gjitha viset e Perandorisë Osmane. Shumë prej luftëtarëve, që ranë dëshmorë në atë luftë, ishin nga viset shqiptare. Kryesisht nga Shkodra, Elbasani, Tirana, Shkupi, Tetova, Prishtina, Prizreni etj.

kërkoj hallallëk për ty inshallah!” Pas kësaj bisede të shkurtër, luftëtari dha shpirt në krahët e komandantit dhe fjalët e tij të fundit ishin:

“I thoni të ma bëjë hallall!..

Pa kaluar shumë kohë, në atë vend vijnë të plagosur të tjerë. Madje, shumë prej tyre japin shpirt pa ardhur në vendin e ndihmës së parë. Sendet personale që gjenden në trupin e këtyre dëshmorëve, dërgohen menjëherë tek komandanti. Dhe ja, përsëri një medaljon dhe një pusullë...

Komandanti, që ende nuk e kishte marrë veten prej gjendjes shpirtërore shumë prekëse që i kishte shkaktuar ndodhia e pak çasteve më parë, sapo lexoi pusullën që i sollën, këputet në vend. E mbuloi fytyrën me duar dhe nuk mundi të ndalojë as të dridhurat e trupit dhe as lotët që i rridhnin si ujëvarë...

Në pusullë shkruhej:

“Unë i kisha dhënë 1 mexhite borxh Halilit prej fshatit Bejbash. Ai nuk arriti të më takonte përsëri. Pas pak do të kalojmë në sulm. Mbase edhe unë nuk do të kem mundësi ta shoh më atë. Shoku im është shumë i kujdesshëm ndaj hakut të robit. I thoni atij të mos shqetësohet, sepse unë ia kam bërë hallall.”

Ja pra, kjo është mirësia e veçantë e Allahut Teala ndaj një zemre të sinqertë, që dridhet nga shkelja e hakut të robit!..

E gjithë bota është dëshmitare se forca materiale e ushtarëve tanë ndaj armikut në Luftën e Çanakalesë, ishte shumë e vogël, për të mos thënë asgjë. Luftëtarët tanë, ndonjëherë nuk gjenin çizme për t'i veshur, nuk gjenin kapotë për ta hedhur krahëve dhe ndonjëherë nuk gjenin as plumba për t'ia hedhur armikut. Mirëpo, kraharorët e tyre ishin të mbushur me besim dhe fuqia shpirtërore e atij brezi heroik, e shkatërroi forcën materiale të armikut. Kjo, sepse

nëse forca shpirtërore është më e madhe, fiton mbi forcën materiale. Komandanti dhe historiani anglez Hamilton, që mori pjesë në luftën e Çanakalesë, këtë fakt e ka shprehur me këto fjalë:

“Ne nuk na munda fuqia materiale, por fuqia shpirtërore e turqve, sepse atyre nuk u kishte ngelur as barut për ta përdorur. Ne pamë forcat (ndihmëse) që u zbrisnin nga qielli!..”

Në këtë mënyrë, ushtria jonë besimtare, në Çanakale nuk shkroi vetëm legjendën e heroizmit dhe trimërisë, por në të njëjtën kohë, me begatinë e pjekurisë shpirtërore që zotëronte, shkroi edhe një legjendë virtytesh.

Kjo ndodhi është një shembull i shkëlqyer që tregon se ushtarët që morën pjesë në atë luftë, zotëronin një shpirt, i cili ishte brumosur me ajetin:

“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.” (Fatiha, 5)

Premtimi hyjnor për ata që zotërojnë një shpirt me pjekuri të tillë, shprehet më së miri në këtë ajet fisnik:

“...Sa herë, me ndihmën e Allahut, një ushtri e vogël ka ngadhënjyer mbi një ushtri të madhe!..” (Bekare, 249)

Megjithëse Allahu Teala i fal gabimet dhe gjynahet që bëhen ndaj Tij, hakun e robit e ka lënë jashtë faljes hyjnore. Atë e ka lënë në dorën e robit që i është bërë padrejtësi. Pra-ndaj, është vënë kusht që, nëse dikush dëshiron të pendohet për padrejtësitë që ka bërë, më parë duhet të kërkojë hallallëk prej atij personi të cilit i ka bërë padrejtësi. Kjo sepse, nëse nuk merret hallallëk, gjendja në të cilën do të bjerë njeriu në Ditën e Kijametit do të jetë ashtu siç përshkruhet në këtë hadith fisnik:

“Kush i ka bërë vëllait të fesë ndonjë padrejtësi në nder apo në pasuri, të hallallohet me të para se të vijë Dita e Kijametit, ku nuk do të ketë flori dhe argjend. Në të kundërtën, nëse ka vepra të mira, do t'i merren prej sevapeve të tij aq sa ka bërë padrejtësi. (dhe i jepet atij që i është bërë padrejtësi). Por, nëse nuk ka vepra të mira, do të merren prej gjynabeve të vëllait që i ka bërë padrejtësi dhe do t'i ngarkohen atij.” (Buhari, Mezalim, 10, Rikak, 48)

Ndërsa në një ajet fisnik urdhërohet:

“Frikësojuni Ditës kur askush nuk do të mund të bëjë asgjë për askënd dhe, kur prej askujt nuk do të pranohet as ndërmjetësim, as shpërblësë e as që do të ndihmoheni.” (Bekare, 48)

Pra, gjendja e atij që shkon në botën tjetër duke u ngarkuar me padrejtësi ndaj njerëzve në këtë botë, nuk do të jetë tjetër veçse një humbje dhe mjerim i madh. Atje nuk do të ketë as vend për t'u fshehur dhe as mundësi për t'u kthyer pas.

Profeti ynë (a.s.), në një hadith fisnik, na paralajmëron që të mos shkojmë në haxh me para haram dhe duke pasur mbi supet hakun e ndonjë robi:

“Kush e viziton këtë Shtëpi (Qabenë) me para që i ka fituar në rrugë haram, del nga bindja ndaj Allahut. Kur një njeri i tillë bën njetin për haxh, futet në ihram dhe, pasi ka hipur në devenë e tij, thotë –Lebbejk Allahumme Lebbejk,– një thirrës thërret nga qielli:

“Për ty nuk ka as lebejk, as sa'dejk! Sepse fitimi yt është haram, ushqimi yt është haram, kafsha ku ke hipur është haram. Kthehu si gjynahqar, pa marrë asnjë sevap! Hidhërohu, për shkak se do të përballesh me një gjë që nuk të pëlqen aspak!”

Por kush del në udhëtimin për në haxh me para hallall, hipën në kafshën e vet duke e cytur atë të ecë dhe thotë “Lebbejk Allahumme Lebbejk”, një thirrës, thërret nga qielli:

“Lebbejk dhe Sa'dejk! T'u përgjigja, sepse kafsha ku ke hipur është hallall, rroba që ke veshur, është hallall, ushqimi yt, është hallall. Kthehu me sevape të mëdha dhe pa u ngarkuar me asnjë

gjynah! Gëzohu, për shkak se do të përballesh me atë që do të të pëlqejë dhe do të të lumturojë!” (Hejthemi, III, 209-210)

Profeti (a.s.), i cili ia mësoi umetit të vet këto të vërteta, edhe në frymën e fundit, derisa iu shua fare zëri i bekuar, vazhdoi të jepte këto dy porosi:

1- Kini frikë Allahun, në lidhje me namazin (që është lidhja e robit me Zotin e vet)

2- Kini frikë Allahun, në lidhje me njerëzit që keni nën urdhrat tuaja... (Bejhaki, Shuab, VII, 477)

Ja Rabbi! Me bujarinë dhe mëshirën tënde na e bëj të mundur të dalim para Teje me ndërgjegje të pastër, në lidhje me hakun e robit...

Amin!..



SINQERITETI

paqja e zemrës

Ka njerëz të cilëve u shkëlqejnë fytyrat nga drita që kanë në shpirt; të gjithë ne mezi presim që t'i shikojmë... Sytë e tyre nuk përmbajnë asnjë hije dyshimi apo shqetësimi...

Ekzistojnë fjalë të tilla të ëmbla, që të mbushin me një qetësi të fuqishme dhe të përkëdhelin shpirtin...

Ka sy të tillë që të shtojnë jetë...

Ka buzëqeshje që në momentin që shfaqen në fytyrë të bëjnë të harrosh çdo shqetësim dhe problem; në këto buzëqeshje fshihet një gur i çmuar, emri i tij është sinqeritet... I zbritur nga qielli në tokë, i pastër si drita e parë e mëngjesit, qetësi e mbushur me dritë.

Sinqeriteti është si një besimtar i përlur, por me qëndrim madhështor që jeton brenda nesh... Nga ana tjetër ai është edhe i vetmuar. Ai nuk përzihet me gjërat e tjera të kësaj bote...

Sinqeriteti është si një bahçe me shumë fruta. Njerëzit që e kanë këtë bahçe janë të pasur nga çdo aspekt, janë të pasur në dashuri, besim dhe bujari... Ata nuk i përlulen askujt veç Allahut... Ata shijojnë bukurinë e besimit...

Në mahsher sillet një fletore e mbushur me sexhde dhe bamirësi. I zoti i këtyre i shikon me vëmendje punët e vendosura në peshore. Shikon se veprat e tij u zhveshëm dhe pyet me frikë:

"Ku janë adhurimet që kam bërë ditë e natë?"

Menjëherë vjen një përgjigje:


"Punët e bëra pa sinqeritet nuk kanë vend në peshore!... Nëse ka hipokrizi, çdo gjë humbet!..."

Nganjëherë sinqeriteti është si një besimtar që fle në zemra. Pret zgjimin, pret një pendim të thellë. Pret një pendim që ta kthejë në rrugë të drejtë.

Sinqeriteti është një dhuratë që Allahu u jep njerëzve që kanë kujdes për të mos devijuar nga rruga e drejtë... Allahu ua jep këtë bekim njerëzve që lënë gjumin e ëmbël të natës për t'u përkulur para Krijuesit dhe për t'iu lutur Atij; atyre që bëjnë kujdes për të mos rënë në grackën e shejtanit... Le të kujtojmë ajetin :

Iblisi tha: "Zoti im, për shkak se më çove në humbje, unë do t'ju zbukuroj atyre (njerëzve) rrugën e gabuar në Tokë dhe të gjithë do t'i shpie në mashtrim, përveç robërve të Tu të singertë."
(Hixhr , 39-40)

Nga ky ajet kuptojmë se njerëzit e



sinqertë janë të mbrojtur nga kurthet e shejtanit.

Njerëzit e sinqertë kanë forcën për t'i dalë kundër çdokujt në këtë botë. Kjo është një dhuratë e madhe e Zotit.

Në luftën e Bedrit sinqeriteti u bë shpata e mprehtë e heronjve trima...

Guximi i njeriut të sinqertë Hamzasë bëri të dridhej mali Uhud...

Sinqeriteti freskoi zjarrin e zemërimit të Xhafer Sadikut. Një shërbëtor i tij kishte thyer diçka shumë të çmuar dhe i kishte ndotur veshjen por ai i kërkoi falje duke përmendur ajetin: **"... e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit."** (Al- Imran, 134). Xhafer Sadik e fali shërbëtorin që ia kujtoi këtë ajet dhe në këtë mënyrë na tregoi neve se si zbatohet ky ajet.

Sinqeritetin e kemi njohur në nënshtrimin e Haxherit. Në shkretëtirën e pafund nuk kishte asgjë përveç yjeve, Haxherit dhe një fëmije. Zemra e Haxherit që i lutej Zotit ishte pasuria e vetme në këtë çast të vështirë. Ajo i drejtoi duart drejt qiellit dhe filloi të lutej me sinqeritet... Pas thirrjes së saj të përzemërt pranë këmbëve të Ismailit filloi të buronte uji i zemzemit...

Sinqeriteti ishte në nënshtrimin e Ibrahimit përpara zjarrit... Sinqeriteti e shpëtoi atë prej zjarrit. Ibrahim i kuptoi se duhet të gjente shkakun e çdo gjëje dhe tha: "Ai që ndez zjarrin, e fik atë!.."

Sinqeriteti i hapi dyert e xhenetit Nexharit që tha: "Si të mos adhuroj Zotin që më ka krijuar mua?!"... Kur erdhën lajmëtarët e Zotit, përkrahu dhe i kërkoi fisit të vet që t'i besonin. Kur po mbyllte sytë me pikëllim, tha:

"Ah sikur edhe fisi im të kishte besuar!.."

Na pastro zemrat o Allah, ashtu siç ua ke pastruar njerëzve të Tu të sinqertë... Mbushi ato me pastërti dhe qetësi...

Pastërtia e shpirtit dhe sinqeriteti qofshin stoli të zemrave tona!..

Buzë mbramjes


Buzë mbramjes n'këtë qytet fluturon trishtimi i frikshëm
violina që vajtojnë, kitara që tallen
prendon mbretin e diellit mbi kupën e xhamisë
atë besnikët e fesë mendushëm rrijnë e falen.

Mendushëm edhe unë kërkoi të shof tej qiellit
mes engjëjsh sundon arshin, Krijuesi i shpirtit tim
rreth meje fryn tërbushëm vetmia me pak shpresë
e ti o mëkat i hershëm sërish më vjen në kujtim.

...E befas e gjej veten mes kangëve të lumit
nën vjet ngjyrë vjolloçë, mbi tokën e premtume
e du ta rrok tanë qiellin me një puthje të vetme
se tash në paqe jam, pa të ardhme, pa të kalume.

Hira





Singeriteti në adhurim dhe në shërbim

Në Kuran thuhet:

"Xbindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë." (Dhariat, 56)

Me këtë ajet Allahu na e ka bërë shumë të qartë detyrën tonë kryesore.

Fjala ibadet (adhurim) do të thotë: "të përulesh, të bindesh, të jesh rob, të lidhesh me diçka dhe të mos ndahesh prej saj". Kjo fjalë përmendet 256 herë në Kuran, sepse adhurimi është një nga pikat kryesore në jetën e një njeriu.

Njeriu që adhuron Allahun dhe i nënshtrohet Atij, edukon shpirtin e vet dhe në të njëjtën kohë zbaton ligjet e Allahut dhe bëhet nga njerëzit e Tij të dashur.

"Robi im nuk mund të më afrohet në asnjë mënyrë më të përshtatshme se me adhurim. Robi im vazhdon të më afrohet Mua me adhurimet nafile. Më në fund unë e dua atë. Kur Unë e dua një njeri bëhem veshi që ai dëgjon, syri që ai shikon, dora që mban gjëra, këmba që ec. Unë i dhuroj çdo gjë që ai kërkon (me fjalë). Kur mbështetet

tek Unë, e mbroj atë...” (Buhari, Rikak, 38)

Për të kryer më mirë adhurimet tona ne kemi nevojë të njohim më mirë Allahun dhe fenë islame. Le të kuptojmë që Allahu është Krijuesi i gjithësisë dhe çdo gjëje që ekziston në të. Ai është Një, nuk ka shok. Ai nuk ka nevojë për askënd dhe për asgjë. Është larg nga çdo defekt dhe mangësi. Është më i larti, më i mrekullueshmi dhe më i dashuri. Allahu është Ai që meriton të kujtohet dhe të adhurohet në çdo moment.

Adhurimet që i bëjmë Zotit tonë duhet të jenë të veçanta dhe të çmuara. Duhet të harrojmë ambicien, interesin dhe famën. Adhurimi duhet bërë vetëm për të fituar dashurinë e Tij. Siç ka thënë Imam Gazaliu:

“Diçka që lirohet nga ngatërresat pastrohet. Veprimet e pastra quhen veprime të singerta.” (Ihja Ulumiddin, IV, 379)

Nganjëherë një veprim i thjeshtë, por i bërë me sinqeritet të madh mund të fitojë vlera të mëdha tek Allahu. Pejgamberi ynë është shprehur kështu për këtë temë:

“Kur dikush nga ju jep një sadaka në madhësinë e hurmës nga malli i fituar në rrugë të hallallit, Allahu e pranon këtë sadaka me dorë të djathtë. Pastaj Ai e rrit këtë gjë, e rrit derisa e sjell të madh sa një mal para të zotit.” (Buhari, Zekat 8, Tevhid 23)

Sinqeriteti është të lidhesh me Allahun duke harruar çdo gjë në këtë botë, të krijosh intimitet me Të dhe të jesh i përlotur para Tij ashtu siç duhet. Intimiteti dhe modestia që krijohet ndihmon robin që ta njoh Krijuesin ashtu siç duhet, kjo është gjëja më e vështirë për t’u realizuar. Adhurimet dhe duatë që bëhen në atmosferën e këtij afrimiteti janë veprimet më të pëlqyera të Allahut. Në një hadith kudsî Allahu ka thënë:

“Sinqeriteti është një nga sekretet e mia. Atë e vendos në zemrën e njerëzve të mi më të dashur.” (Taxh, I, 43)

Sinqeriteti është dashuri dhe miqësi. Sinqeriteti mund të fshihet në një pikë loti, në dy rekat namaz, në përkrahjen e një njeriu të vetmuar... Kur ekziston sinqeriteti numrat nuk kanë më asnjë rëndësi. Allahu në një hadith kudsî ka thënë:

“Adhurimi më i bukur që një njeri mund të më bëjë është të qenit i singertë ndaj Meje.” (Ahmed bin Hanbel, V, 254)

Gruaja e Harun Reshidit, zonja Zybejde ishte një grua shumë e drejtë. Ajo shpenzoi një sasi shumë të madhe parash për të ndërtuar një sistem me të cilin pajisi me çezme rrugën nga qyteti i Mekes deri në Arafat. Ajo ka ndërtuar edhe shumë hamame, hane dhe spitale. Kur kjo grua e nderuar vdiq dikush e kishte shikuar në ëndërr dhe e kishte pyetur:

“Ke bërë kaq shumë të mira në këtë botë, sa kushedi

se në çfarë vendi të ngritur të xhenetit ndodhesh tani?!”

Zonja Zybejde i kishte dhënë këtë përgjigje:

“Po, është e vërtetë se Zoti im më dhuroi një vend të lartë, por jo për shkak të veprave të mira që kam bërë në atë botë. Një ditë isha në xhami teksa po këndoheshin ilahi. Në momentin që sazet po na shoqëronin filloi të këndohej ezani. Unë menjëherë thashë:

“Pushoni, dëgjoni ezanin!”

Të gjithë heshtën dhe filluan të dëgjinin ezanin.

Kur u mora në llogari, u përmenden punët e mia, ndër to ishin edhe çezmet që shkonin deri në Arafat... M’u tha mua:

“Të falim ty për hir të respektit që ke treguar ndaj ezanit.”

Sinqeriteti është një takim i veçantë dhe i fshehtë me Allahun. Në këtë takim robi i thjeshtë sjell adhurimet e tij, kurse Allahu sjell shpërblimin e madh.

Resulullahu (a.s.), ka thënë:

“Njerëzit e duruar dhe të singertë ftohen në xhenet pa u marrë në llogari.” (Taberani)





Termi “robëreshë” në Islam



Rukije Gjenyly

Sklavëria nuk ka lindur me Islamin. Sklavëria është një dukuri e cila ka lindur që në luftërat e para që ka shikuar njerëzimi. Në një luftë ka të vdekur, pjesa tjetër bien robër në duart e palës fituese. Fituesit ose i vrasin të gjithë njerëzit që kanë shpëtuar nga lufta ose i marrin ata për të përfutur prej tyre. Në këtë mënyrë ka lindur termi: rob, shërbëtor.

Në Islam zënia rob është e lejuar vetëm në luftë, në asnjë mënyrë tjetër.

Islami e ka ndaluar vrasjen e robërve të luftës. Kur mbaron lufta, ata ndahen mes luftëtarëve ashtu siç ndahen plaçkat e tjera të luftës. Njeriu që i merr mund t'i përdorë si shërbëtorë ose mund t'ua shesë njerëzve të tjerë.

Në Islam skllavëria të luftës u është dhënë statusi i njeriut dhe janë vendosur rregulla të veçanta për ta. Në kohën e injorancës skllavi nuk kishte asnjë ndryshim nga sendet. I zoti mund ta rrihte, ta torturonte ose edhe ta vriste. Askush nuk mund të përzihej në këtë çështje.

Sipas fesë islame, është e ndaluar që një skllavi t'i jepen punë të cilat janë shumë të rënda dhe që ai nuk mund t'i bëjë. Feja jonë i urdhëron pronarët që të sillen mirë me ta, të kujdesen, t'i ushqejnë dhe t'i mbathin. Ata janë një pjesë e familjes, duhen trajtuar si pjesëtarë të familjes.

Gratë robëresha mund të gëzojnë dy statuse:

I pari: Robëreshat ngjajnë me shërbëtoret e ditëve të sotme dhe janë përgjegjëse vetëm për punët e shtëpisë. I zoti i shtëpisë nuk ka të drejtë të kryejë marrëdhënie me to. Sipas rregullave të Islamit, këto robëresha mund të martohen nëse marrin pëlqimit e të zotit. Ato mund të martohen me një njeri tjetër që është rob ose me një njeri të lirë. Pra, lidhja që ka robëresha me të zotin është vetëm lidhje pune. Ajo gatuan dhe bën punët e shtëpisë. 90% e grave që kanë punuar në haremin e sulltanit kanë pasur këtë status. Ndryshimi mes shërbëtoresha robëresha dhe shërbëtoresha të lira është se ato janë më të lirshme në veprim dhe në veshje brenda shtëpisë.

Dua të flas pak për këtë temë me të cilën abuzohet shumë. Auret quhen vendet që nuk duhet shikuar nga njerëzit e tjerë. Pjesët e trupit të cilat duhen mbuluar ndryshojnë në varësi të njeriut (grua, burrë, shërbëtor). Për burrat auret është në pjesën mes barkut dhe gjurit. Për gratë pjesa e aures është i gjithë trupi me përjashtim të fytyrës, duarve dhe këmbës (shputës së këmbës). Për gratë robëresha auret është pjesa mbi gju përveç krahëve dhe kokës; pra krahët, këmbët (deri të këmbët) dhe koka nuk quhen auret. Robëresha duhet të ketë kujdes që të mos zgjojë epshin e atyre që e shikojnë. Duke marrë parasysh këto rregulla mund të kuptojmë që është e pamundur që padishahu të argëtohej me shërbëtorët e veta ashtu siç tregohet në filma apo në libra, sepse feja jonë nuk e lejon këtë gjë dhe pronarët nuk i shikojnë shërbëtorët e tyre në atë mënyrë.

Grupi i dytë i robëreshave: Këto janë robëresha që mund të kenë jetë familjare me pronarët e vet. Këto janë gra të cilat nuk kanë nënshkruar kontratë martesore me asnjë burrë, të lirë apo rob. Në këtë mënyrë robëresha mund të ketë marrëdhënie me pronarin e saj por nëse një ditë ajo mbetet shtatzënë fiton statusin “umm-u veled” dhe shpëton nga robërimi, bëhet një grua e lirë.

Pronari, nëse ka dëshirë mund të martohet me robëreshën me kusht që numri i grave të tij të mos kalojnë numrin katër. Duke qenë se martesë me më shumë se një grua nuk është tema e këtij shkrimi nuk kam dëshirë të zgjatëm më shumë në këtë temë.

Pronari gëzon të drejtën të quajtur: “istifrah” ndaj shërbëtores së vet. Kjo është bërë për të mos lejuar zinanë dhe lidhjet jashtëmartesore.

“Ju ndalohet martesë edhe me gratë që gjenden nën kurorë, përveç atyre që i zini robëresha.” (Nisa, 24)

Në martesë ndryshimi mes gruas së lirë dhe robëreshës është se kjo e fundit nuk ka të drejtë trashëgimie. Robëreshat janë si gratë ligjore të pronarit, prandaj nuk mund të kenë marrëdhënie martesore me asnjë burrë tjetër.

Skllevërit (robërit) nuk janë lënë në mes të rrugës për të mos rrezikuar prishjen e moralit dhe për të ruajtur sigurinë e njerëzve, por u janë dhënë familjeve për shërbim. Në këtë mënyrë shqetësimi: “çfarë do të ha sot, si do ta siguroj fitimin tim?” është zhdukur.

Islami e ka vështirësuar marrjen e një robëreshë aq shumë, sa këtë luks e kishin vetëm familjet shumë të pasura. Njerëzit e varfër duke qenë se me zor mbanin familjen e tyre nuk kishin pretendime për të mbajtur shërbëtorë. Pejgamberi ynë vazhdimisht i ka këshilluar pronarët e shërbëtorëve që të silleshin mirë me to, për më tepër, Ai u ka thënë që kanë përgjegjësi edhe për shkollimin e tyre. Në hadith Ai ka thënë:

“Kush ka një robëreshë t’i japë asaj shkollim, por t’i japë shkollim të mirë. Lërinë të lira ato nëse dëshirojnë të martohen. Pronarët që bëjnë kështu do të shpërblehet në të dy botët.” (Buhari, Itk, 49)

Kur një rob / robëreshë, edhe nëse jeton në kushte shumë të mira kërkon lirinë nga pronari i vet, atëherë pronari nuk mund t’ia mohojë këtë gjë. Pronari i vendos një çmim të arsyeshëm. Robi / robëresha mund të punojë jashtë për të fituar paratë e duhura ose mund të kërkojë pagesë për punën që ka bërë në shtëpinë e pronarit të vet. Në momentin kur i mbledh paratë, rob i mund të fitojë lirinë e vet. Është e këshillueshme që bashkë me lirinë t’i jepet zekat.

Feja islame ka vendosur shumë rregulla në lidhje me të drejtat e robit/ robëreshës.

Islami nuk e ka zhdukur menjëherë robërinë, por ka vendosur rregulla aq të forta sa e ka vështirësuar dhe pamundësuar natyrshëm këtë gjë. Në një kohë kur në një luftë myslimanët merreshin robër nuk ishte e logjikshme që myslimanët të mos e ndiqnin këtë rregull të luftës; prandaj robërimi nuk u ndalua, por siç e kemi thënë më përpara: myslimanët i trajtuan mirë robërit e tyre dhe i ndihmuan që të jetonin me forcat e tyre.

Robërit që dikur i kishin shikuar si armiq myslimanët, kur shikuan mënyrën e tyre të jetesës, u kthyen në myslimanë, zgjodhën rrugën e drejtë. Historia e Islamit është e mbushur me njerëz të mëdhenj (dijetarë, komandantë dhe burra shteti), prindërit e të cilëve kanë përqafuar Islamin teksa kanë qenë robër në shtëpi të familjeve myslimane. Në Egjipt, shteti Memluk u krijua nga njerëz që ishin njohur me Islamin, ndërkohë që kishin qenë robër lufte.

OQEANI I MËSHIRËS

Pejgamberi ynë

- salallahu alejhi ve selem -

Falja është një virtyt i madh. Ajo është një nga virtytet më të dashura të Allahut (xh.sh.). Falja e një njeriu i cili na ka lënduar tregon madhështinë e besimit tonë. Nëse sillemi keq me dikë pasi ai na ka mërzhitur, bëjmë edhe atë që të ashpësohet më shumë dhe në këtë mënyrë të dy palët zhjyten gjithnjë e më shumë në gropën e shejtanit; prandaj një nga detyrat e besimtarit është të jetë **“falës”**. Kjo në të njëjtën kohë është edhe një nga emrat më të bukur të Allahut. A nuk është Ai që e fal robin e vet edhe pas gjithë atyre mëkateve që ai bën?! A nuk është Ai i cili e do robin e Vet me gjithë të metat dhe defektet...

Njeriu është mosmirënjohës dhe e harron faktin që Allahu e ka krijuar atë nga një pikë uji, ai e sfidon Zotin e vet pastaj pendohet dhe i kërkon falje. Në atë moment Allahu nuk e privon nga falja dhe dashuria e Tij. Kjo është Lavdia e Tij, lartësia e Tij. Neve na takon që të marrim sado pak nga këto virtyte të larta.

Besimtari nuk duhet të reagojë kundër njeriut që bën mëkat, por vetëm kundër mëkatit. Njeriu ka natyrë të tillë që mund të gabojë shumë lehtë, prandaj secili nga ne në një moment të caktuar mund të bëjë gabim. Të qortosh gabimet e njerëzve të tjerë pa marrë parasysh që të njëjtin gabim mund ta bëjmë dhe ne, është gabimi më i madh.

Nga studimi i jetës së Pejgamberit (a.s.), kemi shikuar se Ai gjithmonë ka bërë përpjekje për t'i falur njerëzit dhe për t'i harruar gabimet e tyre.

Allahu (xh.sh.), e ka këshilluar kështu Resullahun:

“Trego mëshirë, urdhëro vepra të mira dhe shmangu nga të paditurit!” (Araf, 199)

Një nga duatë që besimtari duhet të përsërisë më shumë, është duaja që Pejgamberi ynë i nderuar i mësoi nënës sonë Aishes:

“O Allah!.. Ti je falës dhe e do faljen, na fal edhe ne!..”

Të falësh një njeri do të thotë që ndjenjat e mëshirës dhe të dashurisë janë më të theksuara në personalitetin tënd.

Në Kuran fjala **“ndëshkim”** është përmendur 117 herë kurse fjala **“falje”** është përmendur 234 herë. Kjo tregon qartë se falja e Allahut është më e fuqishme se zemërimi i Tij.

Ka shumë ajete në të cilat vihet në dukje mëshira e Zotit tonë. Disa nga ato ajete janë:

“Shpërblimi për të keqen është i njëjtë me atë të keqe. Por, atë që fal dhe pajton, e pret shpërblimi i Allahut. Ai, në të vërtetë, nuk i do të padrejtët.” (Shura, 40)

“Çfarëdo fatkeqësie që ju godet, është si pasojë e asaj që keni bërë vetë; por Ai fal shumë.” (Shura, 30)

“Njerëzit e ndershëm dhe të pasur ndër ju të mos betohen se nuk do t'u japin të afërmeve, të varfërve dhe të mërguarve në rrugën e Allahut; le t'i falin ata dhe të mos ua marrin për keq! Vallë, a nuk doni ju që t'ju falë Allahu? Allahu është Falës e Mëshirëplotë.” (Nur, 22)

“Ai e pranon pendimin e robërve të Vet, i fal gjynabet dhe i di të gjitha çfarë punoni ju.” (Shura, 25)

Pejgamberi ynë i dashur ka jetuar një jetë të mbushur me rreziqe, por gjithmonë Ai ka zgjedhur rrugën e faljes. Ai ka pësuar vuajtje të tmerrshme si nga fisi i vet, ashtu edhe nga njerëz të panjohur, por Ai gjithmonë i ka shikuar të gjithë njerëzit si vëllezër të cilët një ditë mund të kthehen në rrugën e drejtë. Ai nuk i ka kritikuar as nuk i ka ndëshkuar.

Ka shumë ngjarje në të cilat shikojmë se Pejgamberi ynë e ka dashur shumë faljen. Një nga këto është mënyra se si Ai u soll me Ikrimen, të birin e Ebu Xhehlit. Ebu Xhehli ishte sjellë shumë keq me myslimanët. Edhe gjatë çlirimit të Mekës ai kishte bërë përpjekje për t'i sulmuar myslimanët. Ndërkohë që për të kishte dalë një urdhër ndëshkimi, ai u largua fshehurazi në Jemen, pastaj me ndërmjetësimin e gruas së vet u kthye pranë Pejgamberit. Ndërkohë që ai priste

dënimin e Resulullahut, ai u prit me fjalët:

“O kalorësi emigrant, mirë se erdhe!” (Tirmidhi, Istizan, 34/ 2735)

Falja e Hebbarit, i cili rrëzoi nga kali vajzën e Tij të dashur Zejnebin, tregon madhështinë e karakterit të Tij.

Hebbar bin Esved ishte një nga armiqtë më të mëdhenj të Islamit. Pejgamberi dhe e bija Zejnep (r.a.), po emigronin nga Meka për në Medine. Ai e gjuajti qëllimisht me shtizë dhe e rrëzoi Zejnebin. Në atë kohë Zejnebi, që ishte shtatzënë dështoi dhe u plagos rëndë. Kjo plagë që mori u bë shkak për vdekjen e saj pas një kohe të shkurtër.

Hebbar kishte kryer shumë krime të ngjashme. Pas çlirimit të Mekës ai u largua dhe nuk u kap kurrë. Kur Resulallahu (a.s.), po qëndronte me shokët e Tij në Medine, ai iu afrua atyre dhe u tha që ishte bërë mysliman. Pejgamberi (a.s.), e fali atë dhe ua ndaloi shokëve të tij talljen me të dhe vënien në lojë të tij.

Pejgamberi ynë kishte falur edhe një magjistar, i cili ishte përpjekur ta lëndonte seriozisht. Kjo na tregon neve se sa i mëshirshëm ka qenë Pejgamberi ynë i dashur.

Pejgamberi e kishte mësuar me anë të vahjit se Lebidi, i shtyrë nga disa njerëz, ishte përpjekur që t'i bënte magji për ta sëmurë dhe për ta bërë të vuante. Pejgamberi ynë nuk e dënoi Lebidin as nuk ia përmendi këtë faj. Ai nuk dënoi as njerëzit e fisit të tij, që e kishin shtyrë për të bërë diçka të tillë.

Nëna jonë Aishe e pyeti:

“Pse nuk e shfaq para njerëzve të vërtetën e këtyre personave që u përpoqën të të bënin magji?”

Pejgamberi ynë i dashur i dha këtë përgjigje të mrekullueshme:

“Allahu i Plotfuqishëm më shëroi mua, unë nuk dua që të përhap të keqen mes njerëzve dhe nuk dua që të sillem keq me ta.” (Buhari, Edeb, 56)

Pejgamberi (a.s.), i lutej pa pushim Allahut për faljen e ymetit të vet.

Mënyra se si sillej me robërit e luftës, mëshira që tregonte ndaj tyre vinte nga natyra e Tij e dhembshur. Gjatë gjithë jetës së Tij Ai nuk ka urryer askënd i nisur nga nefsi i vet. Ai ka dashur për hir të Allahut dhe ka urryer njerëzit që i ka urryer Allahu. Në zemrën e Tij nuk kishte asnjë grimcë urrejtjeje apo xhelozie personale, sepse Ai ishte Pejgamberi i mëshirës dhe i dashurisë. Gjatë udhëtimit të Taifit njerëzve që e torturuan u bëri dua me fjalët:

“O Zot, ata nuk dinë. Sikur të dinin nuk do të vepronin kështu!..”

Ai lutej dhe kërkonte shpëtimin e njerëzve që silleshin keq me Të.

Ai ishte oqean mëshire.

Vahshi ishte njeriu që e vrau në mënyrë të pamëshirshme xhaxhin e tij të dashur Hamzain dhe në mes të luftës gruaja me emrin Hindi kafshoi mushkëritë e të nderuarit Hamza. Kur Hindi u bë myslimane, Pejgamberi ynë e fali pa ngurrar asnjë çast.

Ngjarja ndodhi kështu:

Ditën kur u çlirua Meka, Hindi bashkë me gratë e tjera shkoi pranë Pejgamberit (a.s.), për të kërkuar falje. Ajo e kishte mbuluar fytyrën me shami për të mos u njohur dhe kishte ndërruar veshje. Ajo kishte frikë nga vdekja dhe qëndronte larg Pejgamberit (a.s.). Gratë e tjera nuk flisnin, prandaj Hindi u detyrua që të fliste:

“O Resulullah!.. I falënderuar qoftë Ai i cili e lartësoi fenë e Tij. O Muhamed, unë shpresoj tek falja jote! Unë jam një grua që tashmë i besoj Allahut dhe e dëshmoj këtë gjë!”

Pas këtyre fjalëve, ajo e largoi shaminë e saj nga fytyra dhe tha:

“Unë jam Hind binti Utbe! Allahu i fal të gjitha gjynahet (mëkatet) e së shkuarës. Më fal mua që Allahu të të falë Ty!..”

Resulallahu (a.s.), buzëqeshi dhe e thirri pranë vetes Hindin:

“Ti je Hind binti Utbe?!”

“Po” – iu përgjigj ajo.

I Dërguari i Allahut i tha:

“Mirëdita, mirë se erdhe!..”

Hindi i tha:

“Betohem në Zot, o Resulullah!.. Dje unë nuk doja asgjë më shumë se sa të shikoja të rrënuar Ty dhe ndjekësit e Tul!.. Sot, në mëngjes nuk doja asgjë më shumë se lavdinë dhe nderin Tënd dhe të ndjekësve të Tul!..”

Resulallahu (a.s.), i tha:

“Kjo dëshirë do të rritet edhe më shumë!” (Zemah-sheri, VI, 107)

Pejgamberi ynë i dashur i ka falur të gjithë njerëzit të cilët përqaftonin fenë e drejtë dhe fshiu zemërimin që ekzistonte në zemrat e tyre për të mbjellë besim dhe dashuri në vend të tyre.

Ai ka falur çdokënd, pa marrë parasysh dhimbjen që i ka dhënë. Po zemra jonë, pse është kaq e ngurtë? Si mundemi ne që të fshijmë nga jeta jonë edhe motrën tonë myslimane për një gabim të vogël që bën?!

O Allah, bëj që edhe në zemrat tona të lulëzojnë mëshira dhe dashuria! Na i zgjero zemrat. Mos lejo që të ketë në zemrat tona urrejtje dhe hidhërim ndaj vëllezërve dhe motrave tona myslimane; bëj që të jemi nga njerëzit falës, që e duan faljen dhe që falen!..

Amin.



Përdorimi i parfumit

Një nga dhuratat më të bukura që na ka bërë Zoti është era e mirë (parfumi). Në Islam parfumi është përdorur me qëllimin për të mbajtur pastër veten. Nuk ka pasur asnjëherë përpjekje për të mbuluar një erë tjetër të padëshiruar, siç ka ndodhur në vendet joislame.

Era e mirë ka aftësinë të tërheqë vëmendjen dhe zgjimin e disa ndjenjave që e kanë bërë fenë islame të vendosë disa kufij në lidhje me këtë temë.

Përdorimi i parfumit nga meshkujt

Zbatimi i sunetit nga meshkujt si rrjedhojë edhe përdorimi i parfumit është i lejueshëm (xhaiz) në fenë tonë. Nuk është e lejuar hedhja e parfumit me qëllimin për të joshur gratë e huaja.

Përdorimi i parfumit nga gratë

Ka shumë hadithe që ndalojnë përdorimin e parfumit nga gratë. Arsyeja kryesore për vendosjen e këtij ndalimi është fakti se gruaja është mbrojtëse e moralit të një shoqërie. Është i ndaluar përdorimi i parfumit nga një grua e cila do të dalë në rrugë dhe do të kalojë pranë njerëzve të huaj, sepse gruaja është një krijesë e cila posedon një aromë të këndshme, e cila, nëse do të përzihej me aromën e parfumit do të krijonte një kurth shumë të fuqishëm për burrat të cilët kanë një natyrë të dobët. Kjo gjendje është vërtetuar shumë herë, që në kohët e hershme dhe

deri në ditët e sotme. Islami është një fe e cila ka vendosur rregulla të tilla që të mbrojnë njeriun nga zjarri i xhehenemit, këto rregulla janë vendosur duke marrë parasysh natyrën e njeriut. Ndalimi i përdorimit të parfumit është një nga këto rregulla.

Në hadithe përmendet kështu kjo çështje:

“Gruaja kur del jashtë (në rrugë), të mos hedhë parfum.” (Muslim)

“Nëse një grua hedh parfum dhe del jashtë, pastaj kalon pranë një grupi në mënyrë që ata të dëgjojnë aromën e saj; si për të ashtu edhe për njeriun që e ka shikuar llogaritet si mëkat (zina e syrit).” (Tirmidhi, Edeb, 35/ 2786)

“Nëse një grua hedh parfum dhe vesh rroba të bukura që të marrin sytë, pastaj kalon përpara një grupi; ajo grua bën mëkat të njëjtë me zinanë.” (Ibn Hibban)

“Kur një grua hedh një parfum të fortë dhe djemtë e shikojnë atë, deri kur kthehet në shtëpi është nën zemërimin e Allahut.” (Taberani)

Duket shumë qartë se paralajmërimet që ka bërë Pejgamberi salallahu aljehi ve selem, në lidhje me ndalimin e parfumit tek gratë që dalin jashtë shtëpie kanë si shkak ndikimin që jep kjo gjë tek burrat që ndodhen në vendet ku ajo kalon.

Kur dhe ku mund të përdor një grua parfum?

Hadithet që sapo përmendëm nuk e kanë ndaluar përdorimin e parfumit nga gratë në mënyrë absolute.

Gruaja mund të hedhë parfum kur ndodhet në shtëpi; pranë burrit, fëmijëve, grave të tjera ose burrave me të cilët e ka të ndaluar martesën.

Disa nga dijetarët janë të mendimit se gruaja e ka për detyrë të hedhë parfum dhe të zbukurohet kur ndodhet para bashkëshortit të vet.

Sipas transmetimit të Imran bin Husajn (r.a.), Resulallahu salallahu alejhi ve selem, ka thënë:

“Prej aromave (parfumeve) të burrave më i këndshmi është ai me erë të lehtë dhe ngjyrë të fshehtë, kurse prej aromave të grave më e këndshma është ajo me ngjyrë dhe që nuk përhapet shumë në ajër.” (Tirmidhi, Edeb, 35)

Në kohët e sotme gratë, nga padituria ose ngaqë nuk u japin rëndësi rregullave hedhin parfum edhe pranë njerëzve të huaj. Për shembull, gratë nuk bëjnë kujdes para njerëzve me të cilët takohen çdo ditë; me shitësin, me shoferin etj. Një nga gabimet që bëjnë para këtyre njerëzve është edhe përdorimi i parfumit. Hedhja e parfumit nga gratë të cilat do të dalin në rrugë është ndaluar nga feja jonë, prandaj nuk i shkon një gruaje myslimane që të mos e marrë parasysh këtë rregull të fesë.

Duhet të kemi parasysh që parfumet që përdoren në kohët tona kanë aftësi për të ruajtur erën e tyre për një kohë shumë të gjatë, nganjëherë edhe me ditë të tëra. Një grua myslimane duhet ta mendojë mirë këtë gjë para se të hedhë parfumin, dhe duhet të marrë masa që era të mos vazhdojë të dëgjohet edhe kur del jashtë.

Hedhja e parfumit nga gratë që do të shkojnë në xhami

Një nga vendet në të cilat gruaja nuk duhet të përdorë parfum është xhamia. Këtë e tregojnë hadithet:

“Nëse një nga ju do të shkojë në xhami, të mos përdorë aromë të mirë.” (Muslim, Salat, 14)

Sipas transmetimit të Ebu Hurejre (r.a.), Resulallahu alejhi ve selem, ka thënë:

“Mos i pengoni gratë që të vijnë në xhami për namaz; por ato të vijnë të pastolisura dhe pa hedhur erë të mirë.” (Ebu Davud, Salat, 52)

Nëna jonë Aishe ishte shqetësuar kur kishte shikuar gratë që shkonin në xhami të zbukuruara dhe të parfumuara dhe kishte thënë:

“Sikur Resulallahu salallahu alejhi ve selem, të shikonte se çfarë bëjnë këto gra do t’ua ndalonte daljen nga shtëpia (edhe nëse fjala është për namaz)...” (Buhari, Ezan, 163; Muslim, Salat, 144)

Ndalimi i përdorimit të parfumit nga gratë që shkojnë në xhami është bërë më qëllimin për të ndaluar tërheqjen e vëmendjes së meshkujve që ndodhen aty. Sikur të mos ishte ndaluar kjo gjë, zemra e mashkullit

edhe gjatë namazit do të ishte e zënë nga femra. Sikur të gjitha gratë do të vinin në xhami të parfumuara e gjithë xhamia do të mbushej me atë erë dhe feja jonë nuk e do këtë gjë.

Pejgamberi alejhi ve selem, në veçanti ka ndaluar përdorimin e parfumit për gratë që shkojnë në xhami për faljen e namazit të jasisë.

Zejneb es- Sakafije transmeton se Pejgamberi ynë i nderuar ka thënë:

“Gra! Nëse njëra nga ju do të vijë për të falur namazin e jasisë, të mos përdorë parfum.” (Muslim, salat, 141)

Në një hadith tjetër Pejgamberi ka thënë:

“Cilado grua që ka hedhur parfum, të mos bashkohet me ne në namazin e jasisë.” (Muslim, Salat, 143)

Rëndësia që i jepet namazit të jasisë vjen nga fakti se gratë gjatë natës kanë më shumë nevojë për mbrojtje; është gabim të mendojmë që hedhja e parfumit është e ndaluar vetëm në kohën e namazit të jasisë.

Ibn Haxher (r.a.), ka thënë:

“Vajtja e grave në xhami nuk është e ndaluar, por duhet bërë kujdes në këtë temë; për këtë arsye Pejgamberi e ka ndaluar hedhjen e parfumit dhe stolisjen.” (Ibn Haxher, Fethul Bari, 2/632)

Alkooli që gjendet në përbërjen e disa prej parfumave, a ka ndonjë problem nga aspekti fetar?

Sipas medhhebit Hanefi, në substancat të cilat përmbajnë alkool ka gjurmë të verës, prandaj këto janë gjëra që e prishin namazin. Nuk ka asnjë dëshmi që e ndalon pijen e një lënde dehëse përveç verës (pija e paktë ose e shumtë e të cilës sjell dehjen), prandaj disa dijetarë mendojnë se, nëse trupi i njeriut ose vendi ku falet namazi është i spërkatur me një pije (përveç verës) nuk ndikon në namaz.

Sipas Hanefive, të gjitha mjetet e kozmetikës (kolonja, deodorant, parfum, krem) janë të përfshirë në këtë rregull.

Shkurtimisht mund të themi se ngrënia ose pirja e këtyre produkteve është haram, por përdorimi me një qëllim tjetër është i lejuar. Gjithsesi duhet të jemi të kujdesshëm në përdorimin e çdo produkti i cili përmban alkool, sado e vogël qoftë përqindja e këtij të fundit.

Sipas medhhebit Shafi, përdorimi i lëndëve që përmbajnë alkool është i ndaluar. Sipas tyre përdorimi i parfumit, kolonjës apo deodorantit që përmban alkool është haram.

Allahu na e bëftë të mundur kuptimin dhe zbatimin e rregullave të fesë sonë dhe ndjekjen e shembullit të Resulullahut në mënyrën më të përsosur.

Amin!..

VËZHGIMI HYJNOR

Falma Allada

"Allahu i Plotfuqishëm do të shikojë zemrat tuaja, jo trupin dhe fytyrën tuaj." (Muslim, Birr, 34)

Udhëtimi i adhurimeve të një njeriu është i lidhur me fillimin e këtij udhëtimi...

Ki kujdes kur fut dorën në xhep për të ndihmuar dikë ose kur mendon se çfarë t'i thuash dikujt, sepse në botën tjetër do të shikohet se çfarë ke menduar teksa po e bëje këtë veprim.

A nuk mendoni se sa e bukur është feja jonë, e cila na thotë se kur mendojmë diçka dhe kjo është e mirë, edhe nëse nuk e realizojmë dot, neve na llogaritet si sevap; nga ana tjetër, kur mendojmë diçka të keqe, por nuk e realizojmë atë, atëherë nuk na llogaritet asnjë mëkat. Allahu nuk kërkon prej nesh gjëra materiale, Ai kërkon vetëm vepra të bëra me sinqeritet.

Ne flasim shpesh për faktin se Zoti shikon çdo veprim tonin, sot është dita për ta perceptuar më mirë këtë kamera që na vëzhgon. Detyra jonë si myslimanë është që të jetojmë në mënyrë të tillë që në Ditën e Gjykimit kur do të vihem para llogarisë, të kemi me çfarë të krenohemi. Le të mos lejojmë asnjë minutë nga jeta jonë të kalohet në mënyrë që të kënaqet shejtani.

Zemrat tona të cilat në momente vështirësie i përgjërohen vetëm Allahut e dinë më mirë se vetëm Ai mund të na i zgjidhë problemet... Pikërisht kjo dua e bërë në çaste të vështira është e mbushur me sinqeritet dhe përkushtim... Ky sinqeritet duhet të ekzistojë edhe në çaste lumturie, në çaste qetësie... Duhet të kemi kujdes që të mos biem pre e egos sonë në asnjë moment... Në momentin kur largon një gur nga rruga, mos shiko rreth e rrotull për të mësuar nëse të ka shikuar kush, por shpresoj vetëm për kënaqësinë e Zotit.

Lidhja jonë me Allahun fillon me teuhid... Thuaj: "La ilahe il-lallah" ... Le të dridhet trupi yt teksa dëshmon për Zotin e gjithësisë... Le të rrjedhë fjala e dëshmisë deri në qelizat e tua... Le të largohen mendimet e këqija nga truri yt teksa e shqipton këtë fjalë... Dëshmia se Allahu është i vetëm le të paralizojë çdo përpjekje të egos tënde...

Pas kësaj ne do të jemi gati për të hapur një faqe të

re dhe për të filluar adhurimet tona me përkushtim dhe sinqeritet; do të jemi gati për të ecur në rrugën që të çon në xhenet... Le të na marrë malli për xhenetin dhe t'ua transmetojmë edhe të tjerëve këtë mall...

Një punë që nuk bëhet për të fituar dashurinë e Allahut nuk ka asnjë vlerë... Pritja e një lëvdate nga dikush tjetër ose përpjekja për t'i bërë përshtypje dikujt na i humb vlerat e personalitetit... Na bën që të jemi nevojtari të dikujt tjetër, na bën njerëz pa nivel. Nga ana tjetër, kur çdo gjë që bën e bën për hir të Allahut atëherë të presin dhurata të çmuara në këtë botë dhe në botën tjetër; të pret një rrugë që e ka fillimin këtu dhe fundin në ahiret... Emri i atij që ecën në këtë rrugë është "hero"...

Sinqeriteti në bërjen e punëve të kësaj bote është po aq i rëndësishëm sa përkushtimi në adhurim. Edukata e treguar teksa flasim me dikë, dëshira dhe përpjekja për të fituar vetëm në rrugë të hallallit, të qenit i sinqertë dhe i drejtë më çdokënd, fitimi i bukës së gojës pa i marrë hakun askujt, të vepruarit si një njeri i drejtë edhe në vendet ku jemi të sigurt që nuk po na vëzhgon askush është shenjë e një jete të kaluar me sinqeritet e drejtësi.

Si përfundim...

Le të strehohemi në vendin ku hapen të gjitha dyert: tek dua ja (lutja). Pejgamberi ynë salallahu alejhi ve selem, ka thënë:

"O Allah, Zoti ynë dhe i çdo gjëje! Bëj që unë dhe gjithë njerëzit të jemi të sinqertë (vazhdimisht) në këtë botë dhe në ahiret, o i Lartë dhe Dhuruesi Allah!..." (Ebu Davud, Vitir, 25/1508; Ahmed, IV, 369)

Le të ulim kokat edhe ne dhe t'i lutemi Zotit të gjithësisë, le t'i lutemi që të na mbrojnë ne nga nefsi ynë...

O Allah! Çdo vepër e mirë që bëjmë qoftë një arsye për të na afruar pranë Teje dhe një mënyrë për të fituar dashurinë Tënde. Na bëj neve prej njerëzve që i mbron me sinqeritet, i lartëson me adhurim, i zbukuron me moralin e lartë, i sjell para Teje me fytyra që shkëlqejnë nga krenaria. Amin!

Vlera e shërbimit

Elif Menxhel

Vlera e një veprë është e lidhur me sakrificën që bëhet për ta kryer atë dhe sinqeritetin me të cilën është bërë. Kur ky veprim bëhet për hir të Allahut dhe në kushte shumë të vështira, prej tij përfitohet një begati shumë e madhe, nëse nuk i plotëson këto kushte prej tij nuk kemi ndonjë të mirë. Të punosh pa sinqeritet ngjan me aktin e lënies së një sasive fare në hambar. Sikur fara të ishte mbjell në një arë do të kishte dhënë frytet e saj. Fara, e cila në një sezon jep fidanët e saj, vitin tjetër do të shtojë prodhimtarinë. E njëjta gjë ndodh edhe me shërbimin për hir të Allahut. Punët që bëhen me dashuri dhe sinqeritet zënë vend thellë në zemrat e njerëzve. Fjalët që dalin nga zemra futen në zemër. Në këtë mënyrë, ajo fjalë ndikon për mirë tek njeriu që e ka dëgjuar. Pejgamberi ynë alejhi ve selam, ka thënë:

“Kush hap një rrugë të mirë në Islam, ai do të ketë shpërblim çdo herë që do të vepron ajo...”

Le të kemi kujdes teksa njerëzit e tjerë na marrin shembull, sepse një nga shërbimet më të bukura në rrugën e drejtë është hapja e një rruge të drejtë. Mos të harrojmë se, nëse diçka nuk bëhet me qëllim të pastër dhe me dëshirën për të fituar dashurinë e Allahut, nuk na sjell asnjë të mirë.

Të vepron pa pasur qëllim fitimin e dashurisë së Zotit ngjan me mbajtjen në shpinë të një thesi i cili është me vrimë. Ti lodhesh duke e mbajtur por ai boshatiset dhe nuk të jep asnjë fitim... Nëse në fund të jetës kupton se të gjitha gjërat i ke bërë duke u nisur nga krenaria, egoizmi dhe ambicia, atëherë jeta jote nuk ka pasur asnjë kuptim; ajo jetë është vetëm një pendim i madh për të cilin nuk mund të kthehesh pas për ta ndrequr.

Shërbimi është sakrificë. Si shpërblim i kësaj sakrifice vjen një begati dhe shpërblim hyjnor. Duhet të kemi

kujdes kur shërbejmë, duhet t'i japim çdokujt atë që i takon dhe të mos lëndojmë askënd.

Mos e lini pas dore familjen dhe fëmijët tuaj as për të ndjekur me përpikëri sunetin e Pejgamberit tonë të dashur. Nuk duhet të vrapojmë pas ahiretit duke lënë pas dore çdo gjë të kësaj bote. Nuk duhet të harxhojmë të gjithë kohën tonë për t'i ndihmuar fëmijët e huaj dhe të lëmë pas dore fëmijët tanë. Përgjegjësia jonë primare janë fëmijët tanë dhe familja jonë.

Si fillim ne duhet të kujdesemi për njerëzit tanë më të afërt, pasi ta kryejmë këtë detyrë në se kemi mundësi që të lehtësojmë dhimbjen e njerëzve të tjerë është një plus për ne...

Ata që janë në shërbim të njerëzve për hir të Allahut, duhet ta kuptojnë se kjo mundësi është një dhuratë që jua ka dhënë Allahu. Ata duhet të jenë shumë mirënjohës, duhet të kenë kujdes që të mos i bëjnë njerëzit të ndihen në detyrim. Përlësia nuk i shkon askujt tjetër më shumë se njerëzve që shërbejnë për hir të Allahut. Mëshira, dhembshuria dhe falja e zbukurojnë shërbimin. Për të arritur në këtë pikë duhet të mendojmë që çdokush është më i lartë se ne. Arroganca dhe krenaria e shkatërrojnë personalitetin e njeriut. Krenaria ndërkohë që je duke shërbyer është si një sëmundje vdekjeprurëse.

Allahu na ka dhënë neve një mundësi shumë të mirë; le të tregohemi të dobishëm; le të përdorim duart, gjuhën, trupin, diturinë dhe pasurinë tonë për të qenë të dobishëm në rrugën e Allahut. Secili nga ne mund të bëjë diçka për Allahun. Rëndësi ka të veprojmë në mënyrë që të jemi sa më të dobishëm për njerëzit dhe për Islamin; pra në çdo çast të jetës sonë duhet të bëjmë atë që duhet. Për ta kuptuar dhe jetuar sa më mirë këtë gjë duhet t'i lutemi shumë Allahut. Duhet t'i lutemi pa pushim Allahut që të na drejtojë në rrugë të drejtë dhe të na dhurojë arsyen dhe dëshirën për të bërë përpjekje në këtë rrugë.

Shërbimi për hir të Allahut, i liruar dhe i pandikuar nga dëshirat e shumta të egos na afrojnë shumë me Allahun, na bëjnë të dashur tek njerëzit e tjerë dhe bëjnë që të na llogariten sevape edhe pas vdekjes sonë.

Allahu na dhuroftë një jetë të mbushur me shërbime dhe vepra të dobishme. Na bëftë neve nga njerëzit e Tij të dashur dhe nga të cilët Ai është i kënaqur. Amin!

Komunikimi në familje

Aftësia për të komunikuar dhe zgjidhur problemet

Sado që aftësia e komunikimit të jetë faktor themelor në rregullimin e sistemit familjar, edhe një cilësi tjetër shumë e rëndësishme që duhet të ketë personi është “aftësia për të zgjidhur problemet”.

Nëse pjesëtarët e familjes nuk kanë aftësinë e zgjidhjes së problemeve, edhe pse kanë aftësinë e komunikimit dhe, nëse nuk bien në konsensus duke folur

apo duke shfaqur vullnetin për të arritur zgjidhjen, atëherë problemet hyjnë në një qorrsokak tjetër.

Për shembull, një zonjë e cila përjeton vazhdimisht probleme me vjehrrën e saj, komunikimi i mirë që ka me bashkëshortin, nuk nënkupton zgjidhjen e këtij problemi. Madje në shumicën e rasteve, ndërkohë që komunikimi përmirësohet, edhe personat presin më shumë nga njëri-tjetri.

Kur bashkëshortja arrin t’ia shprehë bashkëshortit qartë dhe me një mënyrë të drejtë komunikimi problemin që përjeton me vjehrrën, ajo që pret nga bashkëshorti është zgjidhja e këtij problemi. Ndërsa zgjidhja që do të dalë në pah, duhet të përmbajë për të dy palët kushtin e “pranimi”. Ja, arritja në përfundimin e këtij “pranimi”, ka të bëjë vetëm me aftësinë e personave për të zgjidhur problemin.

“Aftësia për të komunikuar” është binjake me “aftësinë për të zgjidhur problemin”. Pa ekzistuar njëri, tjetri shpeshherë nuk mund të shprehë kuptime të thella, sepse aftësia për të hyrë në komunikim është “pasive”, ndërsa aftësia për të zgjidhur problemet është “aktive”. Nëse aftësitë pasive nuk aktivizohen në kohën e duhur, e humbin seriozitetin nga bashkëbiseduesi dhe mund të bëhen shkak për lodhjen e trurit.

Kjo gjendje është përmbledhur në një fjalë të urtë turke: “Pasqyra e njeriut është puna, ndërsa fjalët e tij nuk kanë shumë rëndësi”.

Për këtë arsye shumë çifte të cilët duhen pafund me njëri-tjetrin dhe arrijnë të formojnë një komunikim të mirë mes tyre, ngaqë janë të dobët në zgjidhjen e problemeve me të cilët përballen dhe nuk prodhojnë “zgjidhje të përbashkëta” të problemeve, burgosen në një jetë të shqetësuar familjare. Përfundimi i natyrshëm i një jete të tillë familjare të paqetë, bëhet shkak për verbimin e “aftësisë së komunikimit pozitiv” që individët kishin në fillim dhe në vend të saj zhvillohen “mënyrat e komunikimit negativ”, domethënë, mënyrat e komunikimit që mbështeten në “dhunë”.

Kur thuhet komunikim me bazë dhunën, nuk duhet të na vijë menjëherë në mendje dhuna “fizike”,

sepse përvojat tregojnë se dhuna që shikohet më shpesh brenda familjes, është ajo “emocionale” dhe “psikologjike”. Për shembull; bashkëshortët të cilët i humbin aftësitë e komunikimit, zakonisht e gjejnë zgjidhjen e problemeve që i hasin kohë pas kohe duke kufizuar dashurinë dhe interesimin ndaj njëri-tjetrit, për të cilin kanë shumë nevojë.

Në shumë shoqëri, tradicionalisht vihet re se shumë herë, detyrën e zgjidhjes së problemeve në familje, e merr përsipër një individ i vetëm.

Edhe pse në shumë familje funksionon komunikimi i hapur brenda tyre, problemet akumulohen mbi një person të vetëm dhe pjesëtarët e familjes gjithmonë i drejtohen këtij personi për zgjidhjen e problemeve. Një gjendje e tillë bëhet shkak që një person në familje të jetë gjithmonë aktiv dhe të tjerët të ngelin pasivë.

Por sa më aktivë që individët të jenë në familje dhe sa më shumë të ndihmojnë në jetën familjare e në zgjidhjen e problemeve, aq më në harmoni vazhdon edhe jeta në familje. Individët brenda familjes, duke dashur t'i zgjidhin të vetëm problemet, ndoshta mund t'i qetësojnë sadopak individët e tjerë, por mund të lodhen dhe të mërziten duke u përballur të vetëm me problemin. Përkundrazi, lumturia e vërtetë është lumturia kolektive e familjes. Nëse është i lumtur vetëm individ, kjo nuk do të thotë se është e lumtur e gjithë familja.

Lumturia brenda familjes ngjan me “gjendjen e enëve të bashkuara mbi njëra-tjetrën”. Që lumturia të përhapet në familje dhe të përdoret në pjesë të përbashkëta, së pari duhet të jenë të hapura rrugët e komunikimit ndërmjet bashkëshortëve dhe kjo lidhet me aktivitetin e gjithë individëve brenda familjes. Në familje të cilat nuk i kanë të hapura dhe aktive linjat e komunikimit, sado të lartë që ta ketë koeficientin e lumturisë njëri nga anëtarët e familjes, nëse një anëtar tjetër nuk përjeton lumturi, pas një kohe kjo do t'i mërzisë edhe individët e tjerë të cilët përjetojnë një çast gëzim.

Meqë lumturia familjare bëhet e vërtetë vetëm nëse është një lumturi e përbashkët, atëherë individët brenda familjes duhet të jenë përgjegjës të përbashkët për jetën familjare.

Në shumë kultura lokale, ngaqë kryesia e familjes i është dhënë burrit, “sikur” nënkupton se e gjithë përgjegjësia e familjes është lënë vetëm mbi atë person.

Veçanërisht fakti që në zonën e Detit Mesdhe fitimet e “kryetarit të familjes” dhe autoriteti përgjegjës kalon vetëm te meshkujt, bëhet shkak për mbylljen e

rrugëve të komunikimit brenda familjes. Përkundrazi, nëse familja është një institucion me përgjegjësi të përbashkëta, ajo nuk drejtohet nga vendimet që merr vetëm një individ, por duhet të drejtohet me vendime që merren në mënyrë të përbashkët.

Si duhet të drejtohet familja? Me vendime individuale apo të përbashkëta?

Me gjithë ndikimin e madh të Islamit në formimin e qytetërimit oriental, udhëheqja individuale brenda familjes është bërë një zakon.

Nëse shohim qytetërimin islam, administrimi i familjes nuk bëhet vetëm me përpjekjet e një personi, por përkundrazi me konsultime reciproke dhe vendime të përbashkëta. Vendimet që merren në një familje, strategjitë që zbatohen dhe aktivitetet që zhvillohen, nuk janë vendime që mund të merren vetëm nga një person i vetëm, por diçka që duhet të strukturohet me vendime të përbashkëta. Me një fjalë, drejtimi i familjes duhet të bëhet me mbledhje brenda familjes dhe me mekanizmin që formon konsultimi brenda familjes.

Për shembull: “Pejgamberi, (a.s.), mbledh çdo ditë me gratë e Tij në kohën mes iqindisë dhe akshamit, bisedonte me to, me një fjalë bënte mbledhje familjare. Këto takime, biseda, diskutime dhe mbledhje që Pejgamberi, (a.s.), bënte brenda familjes, ndikuan aq shumë në edukimin e Nënave tona (gratë e Pejgamberit), saqë ato zunë vend mes sahabëve më të ditur.”

Mbledhjet brenda familjes, ashtu siç formojnë një pikë të mesme për zgjidhjen e problemeve në familje, ua bëjnë të lehtë anëtarëve të familjes posedimin e një bote të përbashkët sentimentale. Që bashkëshortët të njohin njëri-tjetrin, të njohin karakterin e tyre dhe të japin personalisht këshilla për zgjidhjen, kjo mund të ndodhë vetëm me mbledhjet familjare.

Për më shumë, marrja në mënyrë të përbashkët e vendimeve përgatit një terren të përshtatshëm për zgjidhjet në mënyrë të përbashkët të problemeve me të cilat mund të përballen. Kjo veçanërisht mundëson një kontribut të madh për zhvillimin e personalitetit dhe karakterit të fëmijëve. Fëmijët, kur shohin se gjatë mbledhjeve familjare mendimet e tyre vlerësohen, fjala e tyre merret seriozisht nga ana e prindërve dhe se ata bëhen pjesë e zgjidhjes së problemeve familjare, ndjejnë krenari.

Kur gjatë mbledhjeve familjare pjesëtarët e familjes komunikojnë natyrshëm me njëri-tjetrin, me këtë komunikim të ndjeshëm do të shtohet edhe dashuria mes tyre.

Mos më lër vetëm o ZOT!

Zekerija, (a.s.), ishte nga pejgamberët e bijve të Izraelit. Brezi i tij arrinte deri të Sulejmani, (a.s.). Zekerija, (a.s.), drejtonte shërbimin e prerjes së kurbanit në xhaminë Aksa. Në njërën anë vazhdonte shërbimin në xhaminë Aksa, në anën tjetër merrej me zdrukthëtari për të siguruar jetesën.

Zekerija, (a.s.), u martua me Elisën, e cila vinte nga familja e Sulejmanit, (a.s.). Elisa dhe Hunne ishin dy motra. Hunne ishte gruaja e Imranit dhe nëna e Merjemes, nderi i së cilës përmendet edhe në Kuranin Famëlartë.

Në kohën e Zekerijas, (a.s.), Shami dhe Kudsi ishin në duart e Batllamjusëve. Këta respektonin Bejtu'l-Makdisin dhe shkonin mirë me bijtë e

Izraelit. Paria e këtij populli, në Bejtu'l-Makdis, nuk dilnin kurrë nga tempulli dhe vazhdimisht preokupoheshin me adhurim.

Ato kohë mes bijve të Izraelit nuk kishte pejgamber. Ata i kërkuan Allahut që t'u dërgonte një pejgamber. Më në fund Zekerija, (a.s.), u zgjodh nga Allahu Teala si pejgamber. Zekerija (a.s.), në një çast e gjeti veten në një detyrë të vështirë. Shumica e popullit e kishte lënë fenë e Musait (a.s.) dhe ishte zhytur në mëkate e shthurje. Ndërsa Zekerija (a.s.), ishte plakur. Ai filloi t'i kërkonte Allahut Teala një fëmijë që ta vazhdonte detyrën pas tij, por mosha nuk ia mundësonte që të kishte një fëmijë. Allahu Teala e shpreh kështu kërkesën e tij të sinqertë:

(Kujtoje) Zekerijan, kur iu lut Zotit të vet: "O Zoti im, mos më lër vetëm (pa fëmijë), e Ti je trashëgimtari më i mirë." Ne iu përgjigjëm atij dhe i dburuam Jahjanë, duke ia bërë gruan të aftë (për lindje). Me të vërtetë, ata nxitonin për vepra të mira dhe na luteshin, me shpresë e frikë dhe ishin të përlulur ndaj Nesh." (En-bija, 89-90)

Në një ajet tjetër fisnik Zekerija, (a.s.), i shpreh kështu pamundësinë e kushteve të tij fizike:

"Kur ai e thirri Zotin e vet me lutje të fshehtë, (duke thënë): "O Zoti im! Eshtrat tashmë më janë dobë-



suar, koka më ndriçon nga thinjat dhe asnjëherë nuk kam mbetur i zhgënjyer nga lutja ime për Ty, o Zoti im! Unë u frikësohem (sjelljeve të) të afërmeve të mi pas meje ndërsa bashkëshortja ime është beronjë; andaj, më dhuro nga ana Jote një pasardhës, që të më trashëgojë mua dhe familjen e Jakubit. O Zoti im, bëje atë të pëlqyeshëm (për Ty)!” (Merjem, 3-6)

Allahu Teala nuk e la pa përgjigje kërkesën e tij të sinqertë dhe e përgëzoi atë me Jahjanë, (a.s.).

“O Zekerija, Ne po të japim lajmin e mirë për një djalë që do të quhet Jahja. Askujt nuk ia kemi dhënë këtë emër më parë”. (Merjem, 7)

Zekerija, (a.s.), u habit nga ky përgëzim. Në një farë mënyre, zemra nuk i ishte bindur dhe i tha Allahut:

Ai tha: “O Zoti im, si mund të kem unë djalë, kur bashkëshortja ime është beronjë dhe unë kam arritur pleqërinë e thellë?!” (Merjem, 8)

Sigurisht që kjo pyetje nuk është për të vënë në mëdyshje fuqinë dhe madhësitinë e Allahut Teala. Ndoshta është shprehja e admirimit dhe habisë së një njeriu. Allahu Teala iu përgjigj:

I tha: “Ashtu ka thënë Zoti yt. Kjo për mua është e lehtë. Unë të kam krijuar edhe ty më parë, ndërkohë që nuk ekzistojë.” (Merjem, 9)

Kjo përgjigje e cila i kujtoi atij kohën kur njeriu ishte “asgjë”, ia largoi atij të gjitha mëdyshjet dhe këtë herë me një zemër të bindur Zekerija, (a.s.), iu lut Allahut:

(Zekerija) tha: “O Zoti im, më jep ndonjë shenjë!”

Ai tha: “Shenja jote do të jetë se nuk do të mund të flasësh me njerëzit për tri net, ndonëse do të jesh i shëndoshë.” (Merjem, 10.)

Allahu Teala vuri në pah fuqinë e Tij të pa-fundme me dërgimin e një fëmije te Zekerija i moshuar dhe gruaja e tij shterpë. Pasi Allahu Teala e shpreh këtë në ajetet fisnike të mëposhtme, Jahjasë, (a.s.), lindja e të cilit qe një mrekulli, i drejtohet:

(Pasi lindi djali, iu tha): “O Jahja, rroke fort Librin (Teuratin).” Dhe Ne, kur ende ishte fëmijë, i dhamë mençuri, butësi prej Nesh dhe dëlirësi. Ai ishte besimtar i përkushtuar dhe i sjellshëm ndaj prindërve të vet, nuk ishte i ashpër dhe i padëgjueshëm. Paqja qoftë mbi atë ditën kur ka lindur, ditën kur të vdesë dhe në ditën kur do të ringjallet.” (Merjem, 12-15)

Zekerija me sinqeritetin e lutjeve dhe përkushtimin në shërbim, arriti kënaqësinë e Allahut dhe u nderua me profeci. Më vonë në jetën e tij ai u bë me një djalë që u quajt Jahja dhe mori si detyrë të përkujdesej për xhaminë e Mejremes. Kështu ai qe një nga dëshmitarët më të afërt të mrekullisë së ardhjes në jetë pa baba të Isait (a.s.).

Por kjo botë e sprovimit u bë dëshmitare e vrasjes së atij peygamberi të bekuar me duart gjakatare të tiranëve. Bijtë e Izraelit të cilët e kapën Zekerijen në zgavrën e një peme ku përpiquej të fshihej, e vranë atë duke e prerë me sharrë. Varri i tij ndodhet në Halep të Sirisë. Allahu e mëshiroftë Zekerijan dhe ia mundësoftë që të ndërmjetësojë edhe për ne.

Cilat janë simptomat e sëmundjeve serioze te foshnjat e sapolindura?

Përcaktimi nga prindërit i sëmundjes te një foshnje e sapolindur nuk është shumë i lehtë, sepse bebet nuk mund ta shprehin atë si të rriturit, por ka simptoma që i tregojnë edhe shqetësimet e tyre. Disa nga këto simptoma janë serioze dhe duhet patjetër ndërhyrja urgjente e mjekut; disa nuk janë aq shqetësuese dhe mund të kalohen edhe në shtëpi. Vetëm se gjëja që duhet mbajtur mend gjithmonë për bebet e sapolindura është se sa herë që kanë ndonjë shqetësim, kjo gjë përparon me shpejtësi dhe gjendja rëndohet.

Nëse bebes suaj i prishet papritur regjimi me të cilin jeni mësuar, duhet të mendoni se ka një problem. Nëse te një bebe papritur ndryshon regjimi i ushqyerjes me gji apo i gjumit, nëse për shembull nuk dëshiron të pijë ose të hajë ushqimin, është i lodhur, i mekur, vazhdimisht fle ose nuk fle rregullisht, qan vazhdimisht dhe nuk mund ta qetësojmë, në përgjithësi kjo do të thotë sëmundje.

Të analizojmë simptomat e sëmundjeve serioze te bebet e sapolindura:

Temperatura: Nëse mendoni se bebja juaj ka probleme shëndetësore, mateni menjëherë temperaturën. Matjen e temperaturës duhet t'ia bëni nga anusi. Nëse termometri tregon mbi 38 gradë celsius, ka shumë mundësi që bebja të ketë pësuar ndonjë infeksion. Por jo gjithmonë temperatura e lartë është në proporcion me seriozitetin e sëmundjes. Temperatura e një bebeje të sëmurë mund të mos jetë e lartë, madje nxehtësia e trupit mund të jetë më e ulët se normalja. I matët bebes temperaturën; nëse shikoni se ka temperaturë apo termometri tregon temperaturë më të ulët se normalja, duhet ta dërgoni menjëherë beben te mjeku.

Të qarët e vazhdueshëm: Një bebe e sapolindur zakonisht mund të qajë për një kohë të gjatë. Kjo, edhe pse në shumicën e rasteve buron nga gazrat, mund të jetë një simptomë sëmundjeje. Nëse bebja juaj qan vazhdimisht

dhe nuk qetësohet në asnjë lloj mënyre, qan me zë të çuditshëm dhe të ngjirur ose krejt e kundërta me zë të dobët dhe rënkues, do të thotë se ka një problem serioz dhe beben duhet ta dërgoni menjëherë te mjeku.

Problemi i gjumit: Nëse beben nuk mund ta vini në gjumë, nëse e zë gjumi dhe zgjohet pa kaluar gjysmë ore, ose nuk zgjohet madje as për të pirë apo në kuptimin e plotë të fjalës nuk mund të zgjohet, duket i mekur e i përgjumur, drejtohuni patjetër te mjeku.

Problemi i frymëmarrjes: Shpejtësia e frymëmarrjes ndryshon bashkë me moshën. Te bebet e sapolindura numri i frymëmarrjeve mund të jetë 50 në një minutë. Aktiviteti fizik, të ndenjë të zgjuar, të qarët e shtojnë numrin e frymëmarrjeve. Te bebet e parakohshme ky numër mund të shkojë deri në 60 në minutë. Në fëmijërinë e hershme të qumështit dhe në periudhën e fëmijërisë, 20-40 në minutë; në kohën e fëmijërisë së vonë 15-25 në minutë; ndërsa 15 vjeç e sipër 15-20 në minutë.

Nëse bebes suaj i është vështirësuar frymëmarrja, kjo ndodh vetëm nga bllokimi i hundës nga sekrecionet dhe kur t'i pastroni hundën, problemi do të zgjidhet plotësisht. Por nëse bebja merr frymë me vështirësi dhe shumë shpejt (nëse numri i frymëmarrjeve shkon më shumë se 40 në minutë), nëse gjatë frymëmarrjes flegrat e hundës i hapen dhe i mbyllen, nëse bën një frymëmarrje me gërhitje, nëse gjatë frymëmarrjes kraharori i futet përbrenda, nëse ka tërheqje mes brinjëve të kafazit të kraharorit; këto janë simptoma që tregojnë se frymëmarrja është shqetësuese dhe se duhet të vlerësohet nga mjeku.


Në këtë gjendje duhet të studiohen sëmundja e pamjaftueshmërisë së frymëmarrjes, sëmundjet e zemrës (të lindjes) dhe sëmundjes së fryrjes së mushkërive.

Moskryerja e shkarkimit të duhur në 48 orët e para: Kjo mund të jetë shkak i mungesës apo mosfunksionimit të organeve nga lindja ose për shkak të sëmundjeve të zorrëve, të cilave u nevojitet operacion. Bebet së pari urinojnë gjatë lindjes, menjëherë pas saj ose 24 orët e para të jetës. Ndërsa jashtë dalin në 24 orët e para.



Arsyeja dhe Filozofia

IRI



Një notar profesionist mund të notojë në ujëra të thella pa frikë, duke shijuar në këtë mënyrë bukuritë nënujore. Nuk ka asnjë problem për një besimtar cilësor, i cili ka njohuri të mjaftueshme rreth fesë së tij, të shëtisë nëpër kulturat e popujve të tjerë. Problem është të notosh në ujëra të thella pa ditur not. E rrezikshme është të përballesh me kulturat, botëkuptimet dhe rrymat e tjera filozofike, pa pasur njohuritë e duhura rreth Islamit. Në këtë rast ekziston rreziku për të mbetur nën ndikimin e tyre.

Një tjetër problem që ka sjellë filozofia, është përpjekja e disa pseudofilozofëve dashamirë dhe admirues të filozofisë perëndimore, për ta bazuar mendimin islam mbi themele filozofike. Kjo është një përpjekje tinëzare për të vendosur arsyen mbi shpalljen hyjnore.

TË
RINJ

